http://albanopoli.wordpress.com/

alban guri

“un” dhe Dashuria

-dy ngjyrat e një personaliteti-

kritikë shoqërore

politikë

vargje

frymëzim

dashuri

...për një model cilësor bashkëjetese...

Jam munduar që me këtë përmbledhje të them qartë atë që fort qartë ditëve tona të rëndomta nuk duket. E brenda saj, si qëllim kam patur rritjen në progresion të forcës së fjalës, nëpërmjet së cilës të mund të gjejmë instrumentet e duhura për të evituar kontradiktat. Fjalën e kam vënë në qendër të ambicjeve të mia, duke e kërkuar në kufijtë më të paeksploruar të shpirtit dhe të mendjes njerëzore.

Me besim të madh tek e vërteta, me përulësi por jo me nënshtrim, me devocion e jo me servilizëm, me dinjitet e jo me kryelartësi, me sens drejtësie por jo me arrogancë, u apelohem bashkëmoshatarëve të mi, bashkëqytetarëve të mi dhe gjithë atyre që brenda qënies ndjehen gjymtyrë aktive e jetës shoqërore, të besojnë tek fjala, tek drejtësia, tek paqja dhe dashuria.

E në të njëjtën kohë, pse jo, si një pjesë domethënëse e civilizimit botëror, i ftoj ata për një refleksion kolektiv... duke iu kujtuar se Zoti është Dashuri e se në këtë dashuri do gjejnë zgjidhje gjithë fajet dhe problemet tona, të djeshme e të sotme.

Treguesi i lëndës:

Shoqërore ***faqja***

-Zilia njerëzore armiku më i madh i qytetërimit! ..…….. 3
-Qyteti xhungël ku mbretëron "njeriu"! …… 8
-I miri, i famshmi dhe shumë i keqi njeri ……. 11
-Njeriu Misteri i Fundit i Dashurisë! ……. 12
-Shpata dhe thika ……. 15

politike

-Bashkëjetesa politike …….. 16
-Lepuri dhe luani …….. 21
-Qyteti, i gjati* dhe mendjeshkurtërit …….. 22
-Lufta dhe Paqja, kjo dilemë e madhe! …….. 27
-Politikanët e republikës së dytë …….. 33
-Borgjezi ngrije pak kokën! …….. 38

fragmente dhe esse

-Kënga e Lirisë ……. 44
-"un" dhe Dashuria ……. 47
-Vëllai i popujve-Kalorësi i bardhë ……. 53
-Flokëverdha ……. 54
-Dashuri e Kaltër ……. 55
-Mbi miqësinë ……. 57

ZILIA NJEREZORE, ARMIKU ME I MADH I QYTETERIMIT!

Të gjithë pa përjashtim, flas për ne njerëzit, sot shtrojmë problemin e ecjes përpara si shoqëri duke thënë shpesh "Po si dreqin po shkon kjo punë kështu? Nuk merret vesh asgjë! Njerëzit janë kthyer në kafshë!"... e të tjera si këto. Argumentin mbi kafshën-"njeri" që ka si pikëmbërritje njeriun dhe mundohet t'i ngjajë atij, kam tentuar ta paraqes të detajuar në pjesën e titulluar "Qyteti xhungël ku mbretëron njeriu".

Por problemi ngre kokë dhe ne luftojmë me këto shprehje e ide sa herë që na preken interesa personale, sa herë që dëgjojmë ose vërejmë fenomene që na dëmtojnë ne, ose të njohurit tanë. Bëhemi kështu pjesë e padiskutueshme e observatorit shoqëror, i cili në mënyrë të pakundërshtueshme konstaton se jo vetëm qytetërimi nuk po bën më ecje përpara, por ai po pëson kthim mbrapa. Vlerat po bien kokëposhtë, me rënie të lirë, siç vërtetohet më së miri në ligjet themelore të fizikës kur kurba e energjisë mbërrin pikën e saj kulmore dhe më pas kthehet në nivelin prej nga u nis.

Me këtë shqetësim ballafaqohemi ne shqiptarët e prapambetur... por edhe mbarë bota e zhvilluar e njerëzve. Ka padiskutim një kthim mbrapa në vlera, marrdhënie njerëzore dhe konceptimin mbi të ardhmen sot tek pjesa dërrmuese e individëve. Qëniet, që nganjëherë vetquhen njerëz e nganjëherë sforcohen të sillen si të tillë, nuk kanë më sy të kthjellët për të parë botën, shtëpinë e tyre. Ata tashmë e shohin çdo gjë nëpërmjet ekranit televiziv, reklamave publicitare dhe syzeve të diellit që janë bërë kusht i domozdoshëm për status qytetarie. Ata nuk kanë më memorie. Kanë harruar nga dhe si erdhën deri këtu në vitin 2006 pas Krishtit, në epokën e mirqënies, komoditetit dhe teknologjisë së përparuar. Ata nuk po vlerësojnë më objektivisht dobishmërinë e antibiotikëve, energjisë elektrike, telefonisë, motorrit me djegie të brendshme dhe të mikroproçesorëve. Individët sot e shohin të gjithë këtë arritje si një vitrinë mallrash për t'u blerë dhe për t'u patur brenda sferës private të kontrollit të gjithsekujt. Si një mall pra për t'u vënë në dispozicion të kënaqësive dhe kapriçove të secilit prej tyre që i pëlqen të vetquhet njeri, por që ndoshta i tillë nuk është.

Jo të dashur individë, ose qënie me aspirata të larta njerëzore! Si të doni po ju quaj. Nuk është kështu. Këto arritje të mrekullueshme që përmenda, janë fryt i përpjekjeve dhe i

mundimeve, i luftrave dhe i sakrificave të njerëzimit në mijra vjet. Njerëzit janë përballur gjithnjë me kafshët e pyllit e të malit. Janë përballur me gjithë llojet e fatkeqësive natyrore. Kanë luftuar edhe me mënyrën e grupimit në tufa që kanë si karakteristikë kafshët me fytyrë njeriu të cilat synojnë pushtetin dhe e kanë bërë këtë për të mbojtur vlerat e qytetërimit dhe meritokracinë. Janë përballur edhe me tradhtinë dhe xhelozitë brenda llojit të vet, pa ia kanë arritur këtij stadi që gëzojnë sot…

Por që me naivitet, indiferencë e pa e kuptuar, po e humbasin dalngadalë.

Pra, jam duke vënë theksin në fijen e hollë konceptuale që ndan të mirën nga e keqja, zhvillimin nga regresi, harmoninë midis njerëzve nga përçarja, dashamirësinë ndaj të ngjashmit ose urrejtjen e pashpjegueshme ndaj tij. Dhe kjo gjendje e turbullt, ky sensacion djallëzor, kjo humnerë e errët dhe e thellë në mendjet dhe në zemrat tona, është *zilia*.

Ne shqiptarët kemi gojdhënat tona me *vëllezërit ziliqarë,* ku njëri prej tyre refuzonte të kishte të mira të bollshme, mjaft që të shihte të skamur vëllain tjetër e për t'ia arritur kësaj impenjohej e lutej çdo ditë.

Edhe grupimet e tjera shoqërore, etnike, kulturore, politike, kanë shembujt e tyre mbi këtë argument, ku *zilia* merr supremaci ndaj dashamirësisë dhe bashkëpunimit.

Ne të gjithë po harrojmë të dashur miq, se njerëzimi ka notuar në gjak me mijra vjet për të siguruar zjarrin për t'u ngrohur, veglat e punës, pak drithë, pak bukë, më pas rrotën për të lëvizur, disa kështjella e në vazhdim disa qytete. Më vonë akoma erdhën shkollat, barnat dhe spitalet. Për të mbërritur në shekullin e 20-të ku vetëm në gjysmën e dytë të tij, zhvillimi pati një hov kaq të madh, sa mund të themi se vetëm në 50 vjetët e fundit njeriut iu realizuan pjesa më e madhe e aspiratave të tij. Ai mbërriti deri aty sa të fluturojë.

Përballja me të keqen, me sfidat dhe me paditurinë, i shkaktoi humbje të mëdha njeriut në shekuj, por gjithsesi ai triumfoi. Sot, kurba e zhvillimit ka mbetur në vend. Realisht po kthehet mbrapa për gjithë motivet dhe shembujt që njohim, për ato që thamë më lart dhe për ato që do rendisim më poshtë.

Tronditjet ndihen më të forta aty ku mirqënia ka arritur maksimumin. Tragjedia që *zilia* prodhon, konsumohet më së shumti aty ku nuk mungon asgjë. Vemë re shpesh herë se "metastaza" e *zilisë* avancon pikërisht mes bollëkut; mes bankierëve, industrialistëve, pasanikëve, njerëzve të famshëm. Ajo konsumohet aty ku asnjëri prej nesh nuk sheh më brenda

vetes, brenda shpirtit dhe brenda sferës së jetës tij personale. Kështu njeriu po thërrmohet çdo ditë pa e kuptuar, thjesht nga ekzistenca e tjetrit. Ai turbullohet edhe vetëm duke e parë tjetrin, thjesht duke dëgjuar për të, pavarësisht se trashëgon ose thjesht gëzon të njëjtat kushte shoqërore dhe ekonomike, të cilat shpeshherë janë optimale.

Mbas arritjesh të paimagjinueshme më parë nga ne njerëzit, si garanci për t'i ruajtur këto suksese na ofrohet:

ndërgjegjia, harmonia, bashkëjetesa;

por ne jemi të mposhtur nga *zilia*, nga ky armik tinzar, i padukshëm dhe fatal për njerëzit. Ky element destruktiv ka thërrmuar ide, individë, vëllezër, bashkëshortë, familje, popuj, kombe, kontinente. Ai na përshkon në momentin më të papritur. Në pjesën më të madhe të rasteve ai vjen pikërisht kur jemi të kamur ose të mirëpozicionuar në shoqëri dhe nuk ballafaqohemi më me luftën për mbijetesë. *Zilia* lind pikërisht aty ku koha shpenzohet jo më me punë dhe me prodhimin e diçkaje, ku edhe lodhesh e s'ke kohë për të kultivuar *zilinë*, por duke ndenjur me të tjerët, duke biseduar me ta dhe duke hyrë kështu gabimisht e verbërisht në një kompeticion negativ me viktimën e radhës. Këtu, në këtë kontekst na lind fatkeqësisht pyetja fatale që paralajmëron shfaqjen e *zilisë*: "Po ky more?! Më i mirë se mua i duket vetja?! E ç'është ky?! Kush ishte ky deri dje?! Çfarë ka bërë ky që sot e shoh këtu kaq të sukseshëm dhe dashamirës me të tjerët?!" Kjo është vetëm faza paraprake e një ndjesie që më pas merr përmasa *zilie* të paimagjinueshme dhe dominon negativisht jetën tonë.

Nuk duhet ta ngatërrojmë këtë ndjesi me gjykimin kritik dhe objektiv që na lind kur shohim se një bandit ka shumë para; ose në rastin kur një i paaftë merr një post të rëndësishëm në shoqëri, jo për merita por për rrethana të caktuara favorizuese.

Në rastin e *zilisë* sytë na errësohen, mendja na ngushtohet, ndërgjegja asfiksohet dhe iu hapet rruga instikteve.

Nuk kemi bërë asgjë tjetër përveçse jemi kthyer tek kafsha. Dhe pas kësaj, e vetmja mundësi që na mbetet, është të parashikojmë me ç'ashpërsi do ta luftojmë tjetrin, atë që na shkaktoi zilinë. Të arrijmë të parashikojmë se çfarë tragjedie do të hartojë dhe do të na servirë prapa shpine, vëllai, kushëriri, komshiu, shoku, kolegu, miku, i dashuri, bashkëshorti .

Natyrisht, këtu nuk ka dhe nuk mbetet aspak vend për t'iu gëzuar arritjeve dhe mirqënies kolektive të paguara me gjak, sakrifica dhe mundime mijravjeçare. Jo. Të mposhtur nga *zilia* nuk do të mund të vlerësojmë arritjet tona: makinat, celularët,

shtëpitë, kartën e kreditit, pushimet, gostitë, shkencën që përparon në luftën ndaj sëmundjeve. Nuk do të mund t'i gëzohemi faktit se mund të jetojmë mirë me prindërit, me miqtë; se mund të dashurohemi, të martohemi, të bëhemi prindër, të lemë në këtë botë shenjën tonë njerëzore, veprën dhe punën tonë.

Jo, ne do të kënaqim në rastin e *zilisë* instiktin tonë primitiv, të paarsyeshëm dhe kafshëror. Do ndihemi të kënaqur që pas zilisë së provuar ndaj dikujt ose diçkaje, atë dikushin ose diçkanë ta kemi shkatërruar. Desha të them se do lehtësohemi vetëm kur ta kemi eleminuar shkakun e *zilisë* tonë, viktimën e pafajshme. Atëherë ne do të ndjehemi të qetë dhe do të harrojmë se kemi vendosur me një veprim kryeneç, kafshëror, aspak modern, aspak të qytetëruar, kthimin mbrapa në një kohë kur njerëzimi ka filluar të zhvillohet ndjeshëm.

Ky pra, është armiku më i madh i atij qytetërimit që të gjithë ne predikojmë, që të gjithë ne e duam, që të gjithë ne ia vjelim të mirat deri në abuzim. Ky armik i padukshëm, që ne e justifikojmë, e fshehim me fanatizëm në tunelet e errëta të mendjes tonë, është një fenomen që nuk dënohet ligjërisht. *Zilia* nuk parashikohet nga kode penale, civile apo administrative, nuk gjykohet negativisht në kulturën e përditshme. Ajo ka privilegjin të anashkalohet kur dikush e vë re tek dikush tjetër, madje të mos themi se në të shumtën e rasteve qëllon që i mbyllet goja atij që e vë re manifestimin e rrezikshëm të saj. Jemi ne ata që kritikën ndaj *zilisë* e konsiderojmë gabimisht si burim ngatërresash dhe konfliktesh. Konkretisht dëgjojmë shpesh herë nga njëri-tjetri refrenin moralist: *"Mos u merr me fjalë!"* E për "*fjalë*" në këtë rast, nënkuptojmë qëndrimin kundërshtues që njerëz me virtyt (ose jo) mbajnë ndaj shfaqjes së *zilisë* errësirë-prurëse.

Ne, duke jetuar pa një dimension shpirtëror, do të mundohemi gjithnjë që t'i japim pak rëndësi këtij problemi duke u fokusuar në "*halle më të mëdha të jetës tonë"* -siç shprehemi zakonisht. Do përpiqemi që me optimizëm, kurajo, indiferencë apo nënvlerësim, ta largojmë nga qendra dhe protagonizmi i jetës tonë shoqërore këtë plagë, duke menduar se kështu i kemi vënë fre të keqes.

Sigurisht, njerëzimi ka shumë sfida të rëndësishme përpara tij, si: sëmundjet infektive vdekjeprurëse, ambjentin e ndotur dhe ngrohjen progresive të planetit, abortin dhe dënimin me vdekje. Njerëzimi do përballet me urinë dhe me luftrat dhjetra-qindra

vjeçare që burojnë nga kokëfortësia dhe zemërgurësia e disa popujve,...

Por gjithsesi, i fshehur, tinzar dhe i padënuar deri më sot nga ligjet njerëzore, ky fenomen, *zilia*, mbetet armiku më i rrezikshëm i qytetërimit për mijvjeçarin e ri.

QYTETI XHUNGEL KU MBRETERON "NJERIU"

Historia vetëm përsëritet.

Që nga fillimi i kohrave

Gjërat u krijuan vetëm një herë, në fillimin e kohrave. Më pas, çdo fragment i jetës thjesht u përsërit. Ishte natë, më pas u bë ditë. Mbretëruan kafshët për shumë kohë e në krye ishte gjithnjë ajo më e egra. Dominonin instiktet shtazore. Njeriu erdhi mbi tokë si domosdoshmëri për të zbukuruar jetën, për të promovuar bashkëjetesën dhe ekuilibrin midis natyrës e gjallesave.

Duke ilustruar ciklin e jetës, përrallat dhe rrëfimet e erës tonë kanë përmendur gati në çdo rast Luanin si mbret të xhunglës. Toleranca Krijuese e botës e pranonte konvencionalisht lidershipin kafshëror të Luanit, duke shpresuar thellësisht se njeriu, me përpjekjen dhe ndërgjegjen e tij shpirtërore, do distancohej një ditë nga pylli e do përshtatej drejt një modeli tjetër organizimi dhe bashkëjetese. Në fakt kështu ndodhi. Njeriu krijoi qytetet. Ajo që pritej u realizua. Njeriu krijoi një model komunitar të admirueshëm, i cili veçse, nuk ka zgjatur asnjëherë shumë në kohë.

Kjo ndërprerje e sukseseve njerëzore ka ndodhur sepse shpesh herë kafshë më të egra se Luani që vetquheshin "njerëz", sulmonin qytetet, i pushtonin ato dhe më pas i digjnin. Këta shkatërrues ushqeheshin me kafshë e shpendë gati të gjalla dhe dëfreheshin duke derdhur gjak human. Ata vetquheshin njerëz sepse iu pëlqente të ishin të tillë, por nga dëshira në realitet hendeku ka qënë i madh. Hendeku është i thellë në rrugën drejt këtij objektivi, siç është e thellë humnera dhe dhimbja që pikërisht ato, kafshët, krijonin kur sulmonin njerëzit e vërtetë dhe ambjentin e tyre, qytetet. Pa ndërgjegje dhe pa dashuri, ato ndiheshin më mirë kur i kthenin ato qytete në rrënoja të ndotura e të rrëmujshme.

Natyrisht kafshët me fytyrë njeriu nuk mund të jetonin jashtë habitatit të tyre origjinal, ku buka dhe tepria merreshin me gjak duke shqyer të ngjashmin, deri edhe vëllain. Ato ishin shumë agresive edhe për gjërat më të vogla. Çdo problem të jetës së përditshme mundoheshin ta zgjidhnin me konflikt dhe

përballje. Nuk mund të jetonin jashtë atij habitati ku jashtëqitja kryhej pak metra larg vendit ku konsumohej ngrënia. Ato pinin ujë në një pellg pranë atij pellgut tjetër të krijuar nga urinimi, që ndodhej pikërisht pranë vendit ku ushqeheshin.

E gjitha kjo ndodhte në antitezë të plotë me modelin maestral të zbatuar nga njerëzit, të cilët problematikat i kanë zgjidhur gjithnjë me dashuri, me punë, me djersë dhe jo me gjak.

Kështu njeriu i vërtetë, Ai i Fjalës, i Besimit dhe i Arsyes, vuante energjinë e madhe negative dhe të pakontrolluar të bishës, që donte të ishte njeri dhe për këtë arrinte deri aty sa të vetquhej e tillë. Ajo, kafsha me ambicje, në mënyrë absurde sot, pasi vijon proçesin e saj shkatërrues ndaj qytetërimit, shëtit rrugëve me makina luksoze dhe herë pas here konkuron për t'u zgjedhur në Parlamentet e vendeve që e tolerojnë atë si specie.

Por jo, bisha nuk mund të ishte njeri. Bisha nuk mund të donte tjetrin, të ngjashmin, vëllain. Bisha nuk mund të ndërtonte, zhvillonte dhe zbukuronte qytetet. Bisha nuk mund të donte të bukurën, akademitë e mendimit, artin. Njeriu po. Ai i donte dhe i ndjente të domosdoshme ato, prandaj i krijoi dhe i perfeksionoi në shekuj. Pikërisht për këto veti superiore, shpesh herë gjatë ciklit të historisë së tij, njeriu pësoi dhunën, xhelozinë dhe vrazhdësinë e kafshës.

Kafsha që kërkonte të quhej njeri dhe të sillej si e tillë, mbërriti vetëm sa të ngrihej në dy këmbë duke imituar njeriun. Mbërriti të ecte si njeri, të vishej si njeri, të hante si njeri, të bënte edhe pederasti si një pjesë e madhe e llastuar e njerëzve, por kurrsesi të ndjente dhe të gjykonte si njeri. Aq më pak ajo, kafsha, mundi të sillej dhe të vepronte si njeri.

Sepse njeriu erdhi në botë nëpërmjet Fjalës. Ai u krijua, besoi dhe foli. Edhe ai si Krijuesi i tij, gjykoi dhe veproi në emër të jetës. Krijoi familjen dhe deshi atë. Ndërtoi edhe shtëpi për familjen e tij. Pastaj ndërtoi qytetet. Ndërtoi tempujt që ia dedikoi Krijuesit të tij dhe shkroi libra, me anë të të cilëve u mundua të edukojë fëmijët e tij.

Ndërkaq kafsha, vuante me xhelozi përkryeshmërinë e njeriut dhe kështu e shtytur nga energjia e saj negative tentoi ta imitojë Njeriun në çdo aspekt për ta sfiduar. Por çfarë mund të realizonte bisha pa zotëruar Fjalën e Krijuesit, pa besimin Hyjnor, pa dashurinë njerëzore, pa sensin e organizimit dhe të bashkëjetesës, pa ndjeshmërinë ndaj të bukurës?!

Asgjë.

Ajo me xhelozinë e saj veç prishi, dhunoi dhe i detyroi njerëzit të mbylleshin në tempuj, kuvende, kështjella ose të krijonin qytetet e tyre në male, larg bishave grykëse e ziliqare.

E gjithë kjo dinamikë jete njerëzore kulmoi dhe na ilustrohet me rastin kur bijtë e njeriut u ushqyen nga ulkonja. Fëmijët e shëndetshëm të një komandanti ushtarak, trojanit Enea, mbetën pa nënën e tyre fill pas aktit të lindjes. Nuk dihen mirë arsyet e vdekjes por thuhet se ajo ndodhi në rrethana misterioze. Ata, fëmijët e sapolindur, u gjendën në kufirin midis jetës dhe vdekjes por aty u shfaq kafsha dhe papritur u dha të pinin qumësht nga gjinjtë e saj. Dy djemt e shëndetshëm të prijësit ushtarak kishin mbetur në mëshirën e kafshës e kështuqë ajo, ulkonja, më fisnikia ndër bishat, u dha jetë bijve të njeriut. I rriti të fortë sikur të ishin të sajët, por ndërkohë iu dha energjinë dhe instiktet e kafshës.

Me fizionomi e inteligjencë njerëzore dhe me energji e insitikte ulkonje, dy djemt e heroit ndërtuan një qytetet të madh e të bukur, Romën, të vetmin që historia e vë gjithnjë në qendër të saj. Por në një moment, vetëm në një moment i cili rezultoi fatal dhe mësimdhënës për njerëzit, ata vëllezërit, bijtë e heroit legjendar, u sunduan nga instikti i ulkonjës. U sunduan nga qumështi i kafshës që ata kishin në dejet e tyre.

Për një problem aspak substancial që lindi në mes tyre, pra thjesht për emërtimin e qytetit që ndërtuan, ata vendosën të përballen vëllai me vëllain dhe kështu, në mënyrë tragjike, njëri vrau tjetrin. Ky fenomen është kujtuar gjithmonë nëpër katedrat e mendimit dhe sot përkufizohet si “lufta vëllavrasëse”. Fatkeqësisht kjo luftë përsëritet shpesh në histori.

Midis njerëzve të vërtetë, luftra të tilla nuk ka. Midis tyre mbretëron paqja, harmonia dhe dashuria.

I MIRI, I FAMSHMI DHE SHUME I KEQI NJERI

E madhe e keqja
që fshihet pranë nesh
të bukurën, të mirën
çdo ditë e godet.

Papritmas prej gardhit
të saj të errët del,
këput ritme jete
e keqja pranë nesh.

Ku fshihet, ku fle
kjo bishë shkatërrimtare
që ditët, momentet
na i ngrys na i shkel?

Mos vallë brenda shokut,
vëllait, bashkëshortit
ka gjetur pak vend
dhe kështu na mban peng?!

******

Por shkurt pa i harruar
të tjerët si i thonë
që pa e vrarë shumë mendjen
të keqen mbajnë në shpirt.

Do pyesja pak veten:
-Sa herë vallë edhe unë
si bishë me trajtë njeriu
kam ligështuar miqtë?

-Ky refleksion është frymëzuar
nga vepra e Padër Anton Harapit,
"Vlerë Shpirtërore"

NJERIU, MISTERI I FUNDIT I DASHURISE

Njeriu si njeri u rrëzua, u bë grimcë, u bë i parëndësishëm. U bë një instrument i verbër i makinës lëvizëse të jetës. Mbaroi në asgjë: Demoralizim! Degjenerim! Regres shpirtëror!

Në shekullin e kaluar, aty rreth viteve 30-të, Sekretari i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, iu apelua influencës së botës kristiane për të ndihmuar njerëzimin në krizën e thellë ku ishte zhytur. Europa, që gjendej në atë sallë me anë të përfaqsuesve të vet, u përpoq ta gjente rrugën e shpëtimit me mënyrën e saj dhe vendosi që: "mund të bëjmë edhe pa Zotin!" e u lidh me bolshevikët. Të gjithë e dimë se çfarë ndodhi më pas. U shkatërrua njerëzimi, u prodhuan makineri e bomba bërthamore që u lëshuan mbi njeriun. U vranë, u masakruan, u burgosën dhe poshtëruan njerëzit e Zotit, vetëm se donin lirinë dhe dritën.

"S'duam Zot drejtësie! Larg nga ne Zoti i dashurisë"-thanë udhëheqësit e mendimit njerëzor. "Zoti është parà ! Zoti është makinë! Zoti është forcë!"-thanë dhe thonë akoma sot disa persona të rëndësishëm nëpër botë.

Kështu u shtuan paratë, u shtuan makinat, u shtuan dhuna dhe forca ndaj të njejtëve, ndaj krijesave të Zotit. Sot siç e dini nuk mungojnë as paratë, as makinat, as progresi teknologjik por thjesht mungojnë njerëzit. Kur them njerëz e kam fjalën për njerëz të vërtetë, të lartë, bujarë dhe fisnikë që mund të drejtojnë një komunitet dhe popujt që të përballen me errësirën.

Populli shqiptar thotë: "Zemra e mban njeriun!", e zemra nuk ngopet me tagji, por vetëm me dashuri. Nuk i mungojnë mendjes dhent, por dhenve iu mungon mendja. Pra kopetë duhen ndriçuar se shpirti i njeriut nuk ushqehet me bukë por me virtyt. Kafsha mendon vetëm për të ngënë e pastaj shkon dhe e nxjerr jashtë atë.

Veç ata që njohin fjalën e Zotit e dinë se në fillim u krijuan detrat lumenjtë, malet dhe fushat. Më pas kafshët, shpendët e në

fund njerëzit. U *krijua njeriu*, me shumë *dashuri*. U krijua perfeksioni dhe kjo padyshim që kërkoi shumë Dashuri… Edhe sot në erën e laboratorëve dhe të simpatizantëve të teknologjisë, njeriu vazhdon të lindë prej dashurisë. Absolutisht vetëm prej saj dhe aspak si rrjedhojë e ndonjë shkëmbimi fizik aksidental në raportin burrë-grua. Kjo do të thotë se fëmija ka nevojë të padiskutueshme për dashurinë e nënës që të vijë në jetë! E kjo dashuri e gjen shpjegimin e saj në misterin e krijimit të jetës.

Ata që mundohen ta injorojnë këtë mister dhe që nuk mendojnë mbi parime dashurie, ata që nuk veprojnë drejtë dhe që nuk dashurojnë të barabartin e tyre, nuk mund të jenë njerëz. Ata bëjnë pjesë në grupin e gjallesave që u janë përshtatur kushteve urbane. Janë makina biologjike që vetëm fusin dhe nxjerrin ushqim mekanikisht.

Njeriu është diçka sublime, e papërsëritshme nëpër laboratoret apo sistemet eksperimentale ku fabrikohej "njeriu i ri". Njeriu është një dhe i vetëm. Eshtë magjik dhe i harmonizuar në gjithë universin e tij, me mendje, zemër, sy, fjalë e besim. Njeriu ngre kokën lart e kërkon Atin, siç kërkon fëmija nënën në çdo moment që ka nevojë për ndihmë, afeksion e dashuri. Nëna në rolin e saj të pazëvendësueshëm, merr pjesë intensivisht në fillimet e jetës së fëmijës. Më pas, kur ky fëmijë rritet, nëna mbetet gjithnjë e rëndësishme, por është Ati ai që frymëzon, formon karakterialisht dhe e ndihmon njeriun të përballet me sfidat e forta të jetës.

Nuk mund të jetë njeri ai që nuk thotë një herë "O nëna ime! O Ati im ! O i Madhi Zot!" kur i dhemb zemra, kur kërkon diçka.

Ngjarjet e fundit në Azi, me përmbytjet që vijuan në brigjet e Oqeanit Paqësor (tsunami në Tailandë, Sri Lanka etj), na përsërisin edhe njëherë ato që shkruhen e citohen në Librat e Vjetër, ndëshkimet e para, paralajmërimet e fundit. E atëherë, çfarë përgjigje kanë ndaj këtyre fenomeneve ata që qëllim të jetës së tyre kanë bërë interesat dhe jo idealet? Sa të fuqishëm janë këta individë ndaj këtyre ndodhive? Mendojnë akoma se në këtë botë mjafton të kesh para, komoditete dhe të jesh i fortë fizikisht apo ushtarakisht ndaj të tjerëve? Nuk e di ! Nuk u besoj më këtyre formulave.

Ndoshta disa prej ne njerëzve janë të pandjeshëm ndaj dobësive, por unë shoh se midis shumë të vërtetave ka një të vërtetë shumë domethënëse. Ajo na vë përpara një fakti të pakundërshtueshëm, përpara faktit se kush provon dhimbjen, thotë gjithmonë: "O Nëna ime! O Zot, pse unë?!".

E pra, nënë ka edhe ai të cilit i bëjmë keq. Eshtë edhe ai bir i të njëjtit Zot, njësoj si ne, e pikërisht për këtë gjen mbështetjen e Tij në akte Drejtësie, akte këto që vendosin ekuilibrat shoqërorë që prej fillimit të botës.

Të besosh në Zot, nuk do të thotë vetëm ta përmendësh e të spekullosh me emrin e tij, të shpikësh ligje antinjerëzore në emër të tij, por të ndihesh krijesë dhe mesazher i fjalës së Tij. Kush e bën këtë meriton të quhet njeri.

Njeri mund të quhet vetëm ai që ka një vlerë shpirtërore.

Ai që pranon të jetë misteri i fundit i dashurisë, i dashurisë së përjetshme.

Itali, 1 janar 2005

SHPATA DHE THIKA

Një thikë e vjetër
Po i thoshte shpatës:
unë plagos dhe iu hap barkun
njerëzve të rrugës.
Gjaku që nxjerr
nga këto plagosje
kthehet në një sherr
në një gjakosje.

***

Shpata i përgjigjet:
Edhe unë hap barqe
por i bëj këto gjëra
në duele shpate.
E kur këtë teh
një burrë zotëri e tund,
dueli bëhet ngjarje
dhe kjo ndodh për Kanun.

BASHKEJETESA POLITIKE SI KONCEPT

SUPREMACIA E KONSERVATORIZMIT, E BASHKERENDUAR ME LIBERALIZIMIN E KONTROLLUAR TE TREGUT MUND TE SFIDOJE HEGJEMONINE E SISTEMEVE ANARKISTE DHE BOLSHEVIKE QE PO DOMINOJNE SHOQERINE E SOTME.

Në kohërat që jetojmë, çuditë janë bërë të zakonshme. Zgjidhjet më të qarta dhe lehtësisht të aplikueshme kthehen në të pamundura, të ngatërruara e përtej çdo imagjinate dobiprurëse. Kjo ndodh sepse për motive të diskutueshme dhe aspak emancipuese, pretendohet të ruhet statusi i pushtetarit të privilegjuar nga disa individë të paqytetëruar. Pra, një grup i vogël shoqëror që nuk përbën as përqindje statistikore në popullsi, i cili u kundërvihet vlerave dhe interesave kombëtare, me një të kaluar të shënuar thellësisht nga njolla të errëta dhe kulturë feudalo-komuniste, kërkon të mbajë nën drejtim institucionet, pushtetin.

Pikërisht, kjo vonesë në proçesin qytetërues, prodhon zemërimin e qytetarëve që janë emancipuar sipas disa kritereve dhe normave morale mesatarisht të larta, të cilët janë padyshim maxhoranca absolute në vend, por fatkeqsisht ende të paorganizuar mirë. Ky zemërim, sipas pagabueshmërisë historike, do të kthehet në një "verdikt" ndëshkues ku fjalën e fundit e merr e vërteta, virtyti, ndërgjegja shoqërore dhe drejtësia e vonuar.

Gjithsesi, duhet thënë se, domosdoshmëria për të hequr menjanë modelet bolshevike, të sekretarëve të partisë, të sigurimsave dhe bashkpunëtorëve të tyre, të atyre që besuan dhe punuan për shkatërrimin dhe jo për ndërtimin e shoqërisë, nuk duhet të sjellë detyrimisht liberalizmin anarshist që urren dhe sfidon institucionet dhe kontrollin e tyre të përqendruar.

Liberalizmi, personalisht do të më pëlqente, për mënyrat e tij joshëse të të jetuarit, por ai mbetet një model luksoz i denjë vetëm për vendet ku ka lindur si koncept dhe si vijim është zbatuar jo pa kosto, në burime njerëzore dhe ato materiale. Këto janë vendet me standarte të larta emancipimi dhe qytetërimi. Duke u nisur nga ky fokus mbi gjërat, kam bindjen se kontrasti ndaj së keqes nuk mund dhe nuk duhet bërë as edhe me radikalizmat e tipit "taleban" që rikthejnë errësirën mes jetës së njerëzve.

Zgjidhja për daljen nga çoroditja e organizuar e jetës shoqërore, do të ishte një mënyrë që me marrëveshje fjalësh do ta quanim konservatorizëm. Pra, synohet të arrihet ai objektiv që na

detyron të gjithëve të konservojmë, të ruajmë sadopak atë bashkësi vlerash që kemi: në kulturë, në burime njerëzore, në të mira materiale, në produkte tregtare, në mundësitë e favorshme që na ofron pozicioni gjeografik etj.

Duke rreshtuar në këtë analizë fenomenet negative që vet shoqëria prodhon dhe më pas prej tyre rrezikon të bëjë hapa prapa, padyshim me kosto shumë të lartë, duhet të nxjerrim edhe alternativat.

Radha e gjërave e do që vendin e parë në tabelën e fenomeneve negativë, që kthejnë mbrapsh vektorët shoqërorë, ta mbajë formimi i individit në familje, pra kultura e përvetsuar dhe emancipimi i tij. Në vend të dytë si fenomen që ndikon tek individi, mund të përmendet fakti nëse ai është besimtar apo nuk arrin të besojë dot, ashtu i bindur siç është plotësisht dhe verbërisht tek zbazëtia që e karakterizon.

Në fund dhe ndoshta me më shumë rëndësi se dy të parët, si një fenomen negativ paraqitet të qënurit peng i së kaluarës. Fjala është për modelin e atij individi që ka gabuar një ose qindra herë dhe prej atyre gabimeve nuk ka forcë dhe vizione për të dalë. Ai do të vazhdojë të punojë keq dhe shtrembër, në harmoni dhe skllavëri të plotë ndaj së keqes, me qëllimin e vetëm që të ruajë statusin e një mirqënieje krejtësisht materialiste, status i cili për mënyrën se si është arritur do duhej ta vinte atë individ para drejtësisë dhe ta dënonte publikisht me pasojat që nuk do t'ia uroja askujt. Sepse shpirtërisht, jam i detyruar ta theksoj se, këta individë nuk janë dhe nuk mund të ndjehen mirë, për gjithë motivet që përshkruam më lart si:

pjesmarrja në akte ç'njerëzore me ndërgjegje të plotë, prejardhja familjare me problemet dhe nivelin e saj, pakulturshmëria dhe inferioriteti shoqëror, jeta pa Zotin, pengmbetja ndaj së kaluarës…

e kështu, s'u mbetet tjetër veç t'i gëzohen dhe t'i falen materies që sigurisht i kompromenton.

Në analizë merret "ushtria e pafundme e rekrutëve-politikanë" të sotëm shqiptarë, e ish-pleqve të politikës, e "shkrimtarëve të mëdhenj" me prostat, gazetarëve të paditur e të pangopur, "biznesmenëve" të stimuluar dhe të mbrojtur në pandershmërinë e tyre nga politika provinciale e "rekrutëve" që më kujton Siçilinë e viteve 70-të.

Nga kjo fotografi, shoqërisë i del si detyrë të korrigjojë gabimet e saj. Asaj i del përgjegjësia t'u heqë nga duart pushtetin të "mbyturve nga helmi që ata vetë prodhuan", t'i shpëtojë ata nga modeli i jetës së akrepit, i cili në fund, kur ndjen rrezikun,

thumbon veten me helmin e tij. Në të njëjtën kohë, shoqëria duhet t'i falë dhe t'i rehabilitojë duke i angazhuar nëpër detyra ku imazhi, e kaluara dhe formimi i tyre, mos të influencojnë negativisht proçesin e zhvillimit të vendit.

Pasi vendosëm këto pika të padiskutueshme si kusht për rigjetjen e kurajos dhe ndërgjegjes shoqërore, duhet të bëjmë sëbashku propozimet për vijimin e udhës së rindërtimit të koncepteve bazë për ecjen përpara.

****

Konkretisht me zgjidhje

Në këtë dritare të re, nga e cila mund të shohim dritën e së ardhmes, duhet të ndalojmë të gjithë dhe të sodisim mundësitë që ofrohen duke marrë parasysh edhe situatën ndërkombëtare. Bota ka nevojë të frenojë, të ndalet e të reflektojë mbi arritjet dhe dështimet e saj. Të vlerësojë nëse ka ardhur koha të ruhemi nga "i ftohti" apo me perceptim sipërfaqësor të sillemi sikur jemi në "pranverë".

Zhvillimi i pakontrolluar i teknologjisë duhet të na bëjë të reflektojmë. Sigurisht, me të njëjtin kriter duhet të na shqetësojë avancimi në formën e një spiraleje kokëposhtë i legjislacioneve aktuale mbi të drejtat e njeriut, që në të vërtetë duke pretenduar liritë dhe të drejtën e njeriut për të jetuar, po i dhunojnë ato. Aborti thuhet se i jep liri dhe të drejtë femrës për të zgjedhur, por në të vërtetë e vret jetën që femra mban brenda saj sidhe vetë femrën duke i shkaktuar asaj një traumë jo të vogël fizike dhe psikologjike. Fekondimi i asistuar e gjithfarë "arritjesh" shkencore si këto, bazuar mbi inteligjencën, fillojnë ta kontrollojnë dhe ta modelojnë njeriun, që në të kundërt, është i predispozuar të jetë i lirë dhe natyral, jashtë skemave dhe jashtë programimeve laboratorike që sot aprovohen me ligje parlamentesh "demokratike".

Ne shqiptarët duhet të llogarisim mirë dhe me saktësi, nëse jemi të zhytur në një krizë kulturore, politike, ekonomike dhe shoqërore, apo çdo gjë shkon mos më mirë e atëherë mund t'i lejojmë vetes çdo lloj eksperimenti në kurriz të individit dhe të shoqërisë.

****

Duke u menduar intensivisht dhe duke parë situatën, mund të hartojmë padyshim një platformë konservatore me hapësira të mjaftueshme edhe për konceptet liberale, parë këto si domosdoshmëri për rigjallërimin e tregut vendas dhe investimeve

të huaja. Kjo e gjitha duhet të ndodhë në formulën tashmë të konsoliduar: Konservatorizëm që bashkëjeton dhe kontrollon liberalizmin në një këndvështrim progresiv.

Shëmbulli që na vjen më për shtat është ky që vijon:

I zoti i një pallati prestigjoz të stilit klasik si ato të viteve 700 në qendër të një qyteti europiano-perëndimor, pa hequr dorë nga pronësia mbi këtë pallat, pa hequr dorë gjithashtu edhe nga mënyra e tij e jetesës, pra si një njeri me fuqi blerëse dhe me status prej aristokrati, mund të japë fare mirë leje nëpërmjet një kontrate, që kati i parë i këtij pallati të bëhet një dyqan i bukur me vitrina tërheqëse. Kjo do t'i jepte atij, pronarit konservator, shansin që të mbetet zotërues i pronës, i mënyrës tradicionale të të jetuarit, siç do ta donte edhe kultura e përzgjatur në vite e familjes së tij. Do t'i jepte gjithashtu shansin të përfitonte para të tjera nga kontrata e qirasë së katit të parë, por në të njëjtën kohë do t'i zbukuronte pallatin e kështu do t'i gjallëronte jetesën atij dhe banorëve të tjerë të pallatit.

Padyshim i gjithë qyteti do ndiqte brenda pak kohësh këtë model të mrekullueshëm zhvillimi ekonomik dhe dekori të përkryer, e kështu do të përfitonim një dinamikë të re shoqërore, të pasuruar me më shumë gjallëri e ngjyra bashkëkohore. Natyrisht një dyqan i bukur modern poshtë një pallati klasik, do sillte harmoninë midis tradicjonales dhe modernes. Qytetet mesjetare që sot janë pikat më atraktive për vizitorët e shumtë dhe janë kthyer në valvula qëndrore të ekonomisë së turizmit, na japin pikërisht idenë se si mund të harmonizohen kaq mirë këto dy rryma shoqërore. Konservatorizmi dhe liberalizmi pra, duken disi të largëta me njëri-tjetrin, por do të qëndronin shumë mirë sëbashku si dy gjymtyrë komplementare.

Në këtë harmonizim idesh, gjendjesh shpirtërore dhe botkuptimesh, përfitojnë tri palë:

a) aristokrati, zot i pallatit,

b) tregtari i zgjuar që diti dhe ndërtoi një biznes fitimprurës,

c) shoqëria që tashmë përveç pallatit të mërzitshëm, kishte edhe një dyqan të bukur dhe mundësi për të blerë mallrat që i nevojiteshin.

Ajo çka merr më tepër rëndësi dhe që nuk duhet harruar, është fakti se i zoti i pallatit mund ta kontrollojë tregtarin në çdo moment, pra t'i heqë atij lejen nëse ai e kthen aktivitetin e tij në një aktivitet të paligjshëm ose të padëshirueshëm për banorët e pallatit (si p.sh. qendër prostitucioni ose pikë-shitje narkotikësh). E parë në rastin tonë, pra në organizimin e jetës shoqërore dhe të institucioneve, shembujt që ofruam, duhet të na japin qartësinë të

themi se konservatorizmi mund të marrë supremacinë e orientimit të shoqërisë, duke i lënë vendin e duhur edhe liberalizmit, por duke e kontrolluar atë për faktin se ai ka të metat e veta, mbi të cilat nuk dua të ndalem, por që sigurisht u përmendën në paragrafin mbi liritë dhe të drejtat.

Kështu do të mund të sfidohej hegjemonia e sistemit anarkist ose bolshevik në të cilin tentojnë të na kthejnë mbrapsht disa të prapambetur dhe të pazhvilluar kulturalisht. Jemi duke folur për njerëz që çirren në emër të të drejtave por që e bëjnë këtë *"thjesht për një copë karrige"*- siç thonë ata vetë.

Rezulatatet që mund të prodhonte kjo bashkëjetesë doktrinash janë dhe duhen vlerësuar sipas koefiçientit të kënaqësisë së tri palëve që përdorëm si shembull në simbologjinë tonë: i zoti i pallatit, tregtari flamurtar i liberalizmit dhe banorët e pallatit.

E gjitha është çështje emancipimi dhe vullneti. Mundësitë janë pikërisht aty, në atë dritaren e vizioneve tona e cila pret që ne, në një konsensus të gjerë shoqëror, ta hapim dhe të përfitojmë gjithë energjinë e nevojshme për të jetuar me dinjitet.

maj 2005

përkthimet Trilussa
përshtatur në shqip nga Alban GURI

LEPURI DHE LUANI

Një lepur mendjemadh edhe servil
i thotë Luanit:-Priti thonjtë më mirë!
Hiqi ato armë! Eshtë turp,...s'është e mundur!
Unë si socialist do jem gjithmonë kundër
ndaj çdo armatimi që lëndon
lëkurë njerëzish dhe idealet që mbulojnë!

Po!-i tha luani-do t'i heq.
Për t'u bërë pak mik me socialistin
dhe kështu shkoi drejt tek profesori
që operonte pa anestezistin.
Ai pa humbur kohë rrëmbeu gërshërët,
ja preu thonjtë që mikut ankth i sillnin.

Por ja që po ai lepur ditën tjetër
Kur ujkun pa që qingjin kish në gojë
i trembur dha alarmin:- Oburra kush ta mbrojë!
Dhe Luani pyeti:-Çfarë ka?
"Vrapo, është një ujk! Shpejt, hidhju pra!"
Eehh!-tha ai-Më vjen keq, por s'është shaka.

Në fillim më the: "Hiqi ato armë!"
E tani më thua:"Shpejt t'i shkojmë në ndihmë!"
Si mendon të improvizohet një popull me heronj
ku predikojnë çdo ditë lepujt që kanë frikë?!
Pra, tani prit i dashur mik!
Lind nevoja të më japësh kohë,
të më rriten thonjtë.

Shko ti tek ujku dhe hiqja këtë zakon!
Në rastin më të mirë bjeri edhe kokës...
Me rendin tënd të ditës që prezantove sot
në sallën e kuvendit ku e shite votën.
Ah jo!-u shpreh lepuri,
-Un jam vëlla me ujkun
siç jam me qingjin dhe bretkosën.

QYTETI, I GJATI DHE MENDJESHKURTERIT*

Duket i madh qyteti im
por është veç një grusht,
me brumbuj* shumë.

Tek ecën në këmbë
nuk gjen emrin tënd*
e ke të vështirë
të besosh se po humb.

"Të shporrim borgjezët,
t'i hedhim në rrugë!
Shtëpitë dykatëshe
na zënë tepër vend.

Do ngremë qytetin
e ëndrrave për ne,
pallate të bëjmë
të fitojmë ti dhe unë."

Këtë strategji
të errët si nata
përdorën ata
që drejtojnë prej atëherë.

Ndërsa ne të tjerët
i presim të ngopen,
u bëjmë predikime,
i durojmë pa kriter.
****
Dhe ata "bam me firma",
ndërtimi natyrisht.
-Aaa, nuk them se paratë
i vodhët gjëkund!

Ju erdhët si "zogj"
O "ndërtuesit" e rinj
Si korbat që zbresin
të uritur shumë.

Fëmijë të luftës,
së “lavdishme” padyshim,
trashëguat mësime
nga prindërit që ju thanë:

“Ne kokat po iu presim
atyre me para.
Ju vidhini, mashtrojini
kujdes mos ngrihen prapë!”

E sot kështu pa dashje
gjejmë veten në qytet
Ku mbeti veç sahati*
i gjati monument.

Filloi tatëpjeta
kur hoxhën zunë me gur
dhe priftin masakruan
“ndërtuesit dijeshumë”.

E bënë të rrafshtë çdo gjë
si kokë e tyre shterpë.
Kërkoj qytet për veten
dhe gjej veç “masonier”

Ndërtues siç thonë shqip,
që prishin dhe ndërtojnë.
I shoh tek jargaviten
mendojnë veç të fitojnë,

Pa patur trashëgime
mbi prona bëhen zot,
zënë fort nga një karrige
dhe posti iu jep forcë.

Ju jep shansin të bëhen
“ndërtues”, “arkitektë”,
të ngrenë qytet prej gjakut
të kujt pagoi shtrenjtë.

Dhe nxjerrin një të Gjatë*
që jep firma e leje
i cili halë në sy
i ka pikat dhe presjet*.

I sheh si vogëlsira
që thjesht krijojnë pengesa
“Qyteti shkon përpara,
nuk mund të nxjerrim kleçka!”

“I zoti ky i Gjati”-
thonë pleqt edhe plakat,
“i bëri ca ndryshime”
pa ditur se ç’vjen mbrapa!

“Para, para me grushta,
pa le të vijë qameti”
mendon djali i “ndërtuesit”
të Monument Enverit*.

Ç’e do, nuk i pëlqente
djaloshit “artistik”
qyteti që e rriti
të gjatë, “akademik” .

I dha atë që mundi
qyteti ynë mistik
me ura, harqe, zeje,
që ky i zhduk çdo ditë.

Dhe ëndrrat prap ia nisën
gjumin ta dhunojnë
si 60 vjet përpara
kur zija dominoi.

Ky është ai i Gjati,
“ndërtuesi” energjik
që shpejt na ktheu hijet
e kampit bolshevik.

Firmosi, mori, prishi,
shtëpi e rrugë qyteti,
nën “dritën” e të parëve
me kokën kthyer mbeti

Habitur nga sahati*
që s’prishi dot siç deshi
i biri i “ndërtuesit”
shkatërruesi i qytetit.

E sheh, ndërkaq çuditet
nga lartësi e veprës*,
sheh gjurmët e artistëve
që ndoshta me të qeshen.

brumbujt- *të gjithë parazitët që shoqëria identifikon si ata që po pasurohen në mënyrë të padrejtë.*

emrin* tënd *– kemi parasysh identitetin, veten, të kaluarën, nostalgjitë,*

"firmat" *- janë sinonim i organizimit në struktura gjoja të ligjshme si në rastet e "firmave piramidale", ose në rastet e firmave të ndryshme që kanë vetëm administratorë fantazëm dhe të ardhurat shkojnë tjetërkund.*

"ndërtuesit" *- janë ata që sipas doktrinës bolshevike, nuk besojnë dhe nuk respektojnë objekte kulti, përkundrazi janë gati t'i prishin ato për të ndërtuar ata vetë nga e para "jetën e re", socializmin.*

si "zogj" *– u shfaqën papritur, erdhën nga hiçi, atëherë kur nuk pritej.*

"masonier" *- "ndërtues" siç e shpjeguam më lart; rrjedh nga frengjishtja.*

"arkitektë" *– si "ndërtuesit", bashkëautorë, hartues planesh mbi ecjen përpara (ose mbrapa) të shoqërisë.*

pikat dhe presjet* *– është mënyra e të shprehurit me të cilën nënkuptojmë ligjin.*

"akademik"- *i diplomuar në akademinë e arteve të Tiranës.*

"ndërtuesi" i Monumentit* *- një nga skulptorët e rregjimit, i cili bëri karrierë politike dhe artistike duke ngritur lart figurën e Enver Hoxhës.*

sahati* - *Një nga pak monumentet e kulturës që i kanë mbetur qytetit tonë, si pasojë e vizioneve që patën "baballarët ndërtues" dhe "ndërtuesit e rinj" si ky i Gjati.*

lartësia e veprës* - i referohet veçantisë artistike të sahatit, i cili nuk ka të *krahasuar me asnjë vepër tjetër monumentale-historike në qytet dhe me sa duket pamundësia për ta prishur i shqetëson të paaftët, mediokrit.*

5 janar 2005

Skenari i një "real-film" që përshkruan Shqipërinë post-komuniste

"Dua ujë të pijshëm, të pastër, me shije, të freskët dhe të rrjedhshëm. Nuk dua erë të qelbur paqeje postkomuniste."

LUFTA DHE PAQJA, KJO DILEME E MADHE!

-me pendesë të madhe ndjej për detyrë t'u kërkoj falje lexuesve dhe më pas mirkuptimin atyre, mbi ndonjë fjalë të përdorur tek-tuk pak jashtë dekorit, duke thënë se ishte e pamundur për mua të shprehesha qartë mbi realitetin e përshkruar më poshtë pa frazeologjinë-zhargon.-

*****

Një eseist metropolitan shprehet kështu: "*Në kohë lufte rrjedh gjak e në kohë paqeje derdhet m..."*

Ndërkohë hundët po më shpohen dhe gjendja e të vjellave po zgjatet pa mbarim. Kjo nënkupton se "paqja ramiziane" e pas viteve 90-të po më prish nuhatjen, shijen, sensin estetik sidhe po kompromenton ndjeshëm rrjetin kullues të ujrave të zeza. Shkurt *"punë m...i"*-do thoshte ai eseisti.

Gra e vajza, burra e djem sillen rrotull e mundohen të jetojnë sa më mirë "paqen ramiziane". Në port të pret "barktrashi" i doganës. Në aeroport gjithashtu të ngërdheshet ndonjë "barktrash" tjetër me pushtet dhe me "autoritet". Ai "është i rëndësishëm" sigurisht. Aaaa! Pak rëndësi ka ku e merr rrogën. Në rrugë të gjobit pa të drejtë "barktrashi i rrugores". Poshtë çdo pallati ka një bar të vogël lagjeje ku rri gjithë ditën ulur dhe të fikson me sy idioti "barktrashi i mëhallës". Vazhdon rrjeti i "barktrashëve" të të shfaqet në dyqane, në kafe, në zyrat e administratës, panaire, qendra tregtare, në zyrat e partive politike, në parlament, në makinat e zyrtarëve etj. Mund të them pa fije hezitimi se edhe lypsat në këtë vend po bëhen me bark.

Fatkeqësisht, shpërfytyrimit që sjell barku i tmerrshëm i shtohet edhe një element tjetër antiestetik, koka e trashë dhe e qethur shkurt "për modë" si i thonë. Ndjehem ndërkaq në një gjendje surreale, si në ëndërr. Në një ëndërr të keqe që më projekton si vizitor të një kopshti të madh zoologjik, ku unë shëtis në këmbë dhe i pushtuar nga pasiguria shoh "kafshët paqedashëse" që shëtisin me fuoristrada e makina të shtrenjta, të

cilat njeriu i prodhoi për vete e jo për ato, kafshët e veshura si njerëz.

Por ata nuk janë vetëm

Sipas tezës së pakundërshtueshme se çdo mashkull idiot ka dalë nga barku i një nëne të paemancipuar, vlen të theksohet se "barktrashët" janë vetëm njëra pjesë e komunitetit të madh të *jashtëqitësve* që nuk lodhen duke ngrënë e duke pasuruar qytetin me "*humus*".

Si pjesë plotësuese e këtij kuadri shoqëror kemi femra të shëndetshme (them të shëndetshme vetëm për t'u treguar sadopak xhentil me seksin tjetër) të cilat edhe ato, të martuara ose jo me *burra "shtatzanë"* (barktrashë), pjellin dhe rrisin "barkaluca" të vegjël. Kështu edhe trashëgimtarët e vegjël të "paqes ramiziane" si hap të parë drejt jetës, ndërmarrin akumulimin e kalorive që kthehet përnjëherë në obezitet (mbipeshë).

Në këtë rrugë "paqësore" drejt trashjes, ecën i gjithë komuniteti ynë "trim, dembel dhe paqedashës"... Dhe kështu pra, përpara o "paqedashësi" ynë barktrashë! Shko nga shtatë a tetë herë në ditë në banjë! Paçka se unë thërras: obobobobobo!.. dhe vdes e ringjallem çdo herë që kaloj mbi një pusetë të pambyllur në qytet, në ndonjë cep pallati, ose në mes të kryeqytetit, buzë lumit Lana, ku shoh organin industrialo-prodhues të ndonjë "*paqedashësi*" barktrashë. E shoh atë panoramë degraduese kur kaloj Urën e Madhe mbi Bulevardin Zogu I dhe gjithë urat e tjera të vogla e të mesme mbi lumin e "mrekullueshëm" Lana, që është fytyra e vërtetë e emancipimit ramizian. Shkatërrohem fare gjithashtu kur detyrimisht duhet të futem në banjot e ndonjë lokali publik. Aty, në "banjon-katedër", ku "qartësohen" mendimet dhe shkarkohen sasi industriale "idesh paqësore" që më pas kthehen në "humus".

E unë fatkeqi i paintegruar në këtë sistem "paqedashës" mbaj hundët me dorë për t'i shpëtuar virtualisht dhunës "aromatike" që më ofron "paqja ramiziane". "Paqja" ka krijuar "mirqënie" sasiore e kështu barqet e të trashurve nga truri zmadhohen deri në atë pikë sa shkarkimi biologjik i tyre bëhet i papërballueshëm edhe nga vetë sistemi aktual i ujrave të zeza.

Kjo trashje, përveç barkut, shfaqet edhe në pjesën e mbrapme të kokës, aty ku krijohet ajo shtresa e tmerrshme e dhjamit, në kokën e qethur shkurt prej të burgosuri, që të bën të mendosh se

ndodhesh në një kopsht zoologjik me gorrila e jo në një vend që konvencionalisht quhet qytet. Sepse në të vërtetë, qytet nuk është.

"Paqja", ky skenar ramizian që ka prodhuar trashje barku dhe trashje truri, na tregon se si drejtësia u anashkalua nga një domosdoshmëri shoqërore dhe politike, në një formalitet dhe "shkop politik". Fatkeqësisht demokracia nuk gjeti dot djepin e saj, drejtësinë, pra nuk mundi të rritej e të zhvillohej. Si pasojë, tani kemi vetëm jashtëqitje pa fund dhe kolesterol të pashërueshëm. Kjo e gjitha, u vu në zbatim që ramiz "paqedashësi" të mos ballafaqohej me hijet e së kaluarës dhe me drejtësinë që duhej të bazohej në Istitucionet shekullore të së Drejtës.

Në këtë kohë "paqeje", herë pas here derdhet ndopak gjak por edhe ai pak gjak që derdhet vjen erë të qelbur. Eshtë gjak "burri shtatzan" ose prostituti, si të doni quajeni, i cili për të patur "bukë, qofte, tav dheje, birra dhe maqinë"-siç shprehet ai vet, shiti qënjen e tij dhe gjithë botën që si dhuratë i erdhi nga Dikush tjetër. Ndaj ky, "barkfryri ramizian", si i tillë, me erën e keqe që përhap dhe ngjyrën karakteristike të gjakut "paqedashës" që anon nga kafeja e errët, është në sintoni dhe nuk i lëviz asnjë presje gjendjes asfiksuese në të cilën ndodhemi.

Me pak fjalë, unë them se nuk ka demokraci, nuk ka dije, nuk ka zhvillim, nuk ka kulturë. Nuk ka rini, nuk ka pleq, nuk ka femra, nuk ka edukatorë, nuk ka mësues, nuk ka nxënës. Nuk ka drejtësi, nuk ka parti, nuk ka ide. Nuk ka politikanë, nuk ka akademikë, nuk ka drita (nuk ka as fatura për dritat). Nuk ka ujë, nuk ka as tuba ku të kalojnë ujrat, nuk ka pronësi, nuk ka hipoteka. Nuk ka treg, nuk ka ekonomi tregu, nuk ka "halle". Pra janë të gjithë "rehat". Ka vetëm "paqe", "barkderra" dhe "femra të shëndetshme" të cilët janë protagonistët e një sistemi që krijoi dhe po na imponon akoma sot "paqedashësi" ramiz. Të tjerët, ata që nuk duan dhe nuk pranojnë këtë lloj "paqeje", nuk janë dhe nuk duhen integruar në sistem. Ata nuk quhen fare. Sigurisht, "është e natyrshme. Ata mund të largohen."-predikojnë skenaristët pallatendërtues, "shtatzanët e privilegjuar" të shokut ramiz. Të gjithë pa përjashtim me bark të fryrë dhe këpucë të verdha me majë.

I bie që të largohen ata që nuk duan "paqen ramiziane", ata që "nuk duan m…", ata që nuk pranojnë ta shtyjnë jetën e tyre duke mbajtur hundët me dorë nga neveria që ndjell era e keqe e humusit dhe e vegjetimit kolektiv. Duhet të ikin ata që përçmojnë treçerekun e parlamentarëve, që përçmojnë "biznesmenët" ngjasues të gorrillave të cilët ecin me barkun përpara, me krahët

hapur dhe me çelësat e fuoristradës në dorë, pa harruar këpucët turke me majë dhe me ngjyra nga më të çuditshmet (dominon e verdha dhe e bardha). Duhet të largohen ata që nuk pranojnë zhargonin e tmerrshëm pseudo-tirons, por që në të vërtetë rezulton të jetë një miks midis jevgjitçes dhe injorancës (këta janë të gjithë fëmijët idiotë të ish-kuadrove nga zona e parë ose e dytë operative).

Duhet të emigrojnë sipas këtij modeli "paqësor" pronarët që shohin se si në kohë "paqeje", prona u grabitet nga ish-oficeri i sigurimit të ramizit i cili na konvertohet sa hap e mbyll sytë në një "biznesmen të nderuar" që ndërton pallate mbi pronën e tjetërkujt dhe aspiron më pas të kandidojë si deputet në zgjedhjet e ardhshme.

Në këtë "paqe të mrekullueshme" ku sipas llogjikës "paqësore", nuk duhen ndryshuar tekstet e fëlliqura shkollore të kohës enveriane, ka vend për gjithfarë "publicistësh", "gazetarësh" dhe "opinionistësh", rektorësh e dekanësh, por jo për veprat e vërteta, jo për përkthime dinjitoze. Nuk ka vend për qytetarë, për elitarë, për pinjollë familjesh që së paku prej tre brezash kontribuojnë më shumë në çështjet publike se sa në interesat e tyre personale. Jo. Duhet të promovohet provincializmi asfiksues, primordial dhe grykës. Ai duhet të dominojë krejtësisht jetën shoqërore, publike dhe private. Kështu "paqedashësit ramizianë" nuk do na shqetësohen kurrë me çështje "të drejtash, ligjesh, pronash, grabitjesh, masakrash..." e të tjera si këto. Ata nuk duan "të japin llogari". Kësaj bote "paqedashëse ramiziane" i duhen vetëm derra që shkojnë 7 a 8 herë në ditë në banjo, kriminelë të ricikluar në "biznesmenë", deputetë të veshur me kostume ku dominon viza vertikale dhe me këpucë të verdha kartoni. I nevojiten kësaj bote të pështirë edhe pseudo publicistë të prodhuar në kohë "paqeje". I duhen gjithashtu edhe pseudo-administratorë qytetesh që dinë vetëm të vjedhin parà dhe t'i shpërndajnë ato me kriter të studiuar mirë, domethënë për t'i depozituar nëpër barqe "burrash shtatzanë". Më pas, po këta të fundit, paratë e kthyera në mish dhe hiper kalori, i shkarkojnë nëpër pusetat e shkatërruara të rrjetit kullues. Duhet patur parasysh se për këtë rang të "paarritshëm drejtuesish", para do të thotë automatikisht "bukë, byrek, mish, pilaf, restorant, maqinë, celular...".

**Kjo lloj "paqeje", skenar i "paqedashësit" ramiz alia, e pranuar me cinizëm dhe kompromis nga disa ambasadorë dhe diplomatë të huaj që "ndriçuan" Shqipërinë gjatë këtyre viteve, mban era m... Dhe kjo nuk varet nga dëshirat personale ose sensi*

i lartë i nuhatjes së dikujt, por vjen si pasojë e indiferencës dhe asgjëbërjes kolektive, e vegjetimit fizik, e trashjes mentale dhe e degjenerimit moral.

Pikërisht për këtë "paqeje", që u justifikua dhe u sponsorizua katërcipërisht, me pa të drejtë nga cinizmi dhe nga interesat e ngushta të disa "ambasadorëve fuqiplotë"(jo të gjithë) po imponon luftën. Po imponon luftën ndaj erës së keqe dhe ndaj barqeve të fryrë, ndaj barqeve që mbartin brenda tyre paratë e grabitura që ishin të destinuara për investime publike.

Hundët po më shpohen, më vjen për të vjellë dhe nuk dua të iki drejt ndonjë "paqeje" tjetër, fjala vjen në vende të tjera ku drejtësia çalon njësoj si këtu. Dua të luftoj dinakërinë e "shtatzanisë" ramiziane, injorancën "paqedashëse", obezitetin kafshëror të fëmijëve grykës, humusin që barqet e tmerrshëm prodhojnë pa ndalim, kleptokracinë e huazuar dhe të përvetsuar në kohë rekord nga "njeriu i ri post diktatorial". Dua të luftoj nëpërmjet ideve me "opinionistët" dhe "analistët" të cilëve po t'iu heqësh pjesën e prapme të fjalës, mbeten vetëm një copë prapanicë ku hyn e del çdo lloj "ideje". Dua të luftoj me "gazetarët" që kanë për detyrë t'i thonë gjërat, të informojnë dhe jo të përtypen e të mbllaçiten duke pritur të ardhmen si nënpunësa publikë dhe më pas "me kismet" si deputetë të "nderuar". **Dua të luftoj dhe të shkatërroj emrin e keq prej "shqiptari me brirë" që më vunë tërë këto vite politikanët "paqedashës" të ramiz antishqiptarit.* Dua të luftoj kundër ndenjes ulur gjithë ditën në kafene dhe marrjes së rrogës qyl në administratën publike. Dua të luftoj kundër hermafroditëve të "sistemit" që donte dhe prodhoi "xha ramizi", brenda të cilit nuk jam, nuk pranohem (sa mirë!), por që dua ta ndryshoj dhe të përfshihem. Dua luftën dhe çdo gjë rrjedh prej saj: gjakun, pasionin, vlerat, gjykatat, prokurorët, rjeshtin, rendin, ushtarakun dhe sigurisht zhvillimin e padiskutueshëm. Dua të luftoj që të shoh prokurorë, gjykatës e ushtarakë në punë e sipër duke justifikuar dhe pse jo, duke merituar rrogën e majme që iu ofron sistemi, edhe sikur për këtë të nevojitej hija e rreptë e atyre me grada, heronjve të vërtetë të kombit. Dua të shoh burgje plot me fajtorë dhe klube të boshatisur nga kriminelët "paqedashës" Sepse natyrisht, një krimineli që bën ç'i do qejfi dhe jeton i lumtur "paqen" dhe "shtatzaninë" ramizjane, nuk mund t'i kërkosh ta ndryshojë modelin e tij të jetesës.

"Paqja" po më lodh, po më prish shijen për ta parë botën plot me ngjyra e me poezi përpara një gote me verë. Rrugët e frymëmarrjes më janë infektuar keqas nga ndytësia që prodhojnë

barqet e tmerrshëm “paqësorë”. Kjo edhe si pasojë e një elementi shtesë, i cili karakterizon kohët “paqësore”, pra djersës së lehtë që prodhon një “derr i mbetur shtatzanë nga birra, mishi dhe gënjeshtrat ramiziane”, i cili ha dhe jashtëqet gjithë ditën.

Për këtë motiv dua luftën, ideologjikisht, kuptohet. Dua të luftoj libraritë dhe bibliotekat më të varfra në Europë. Dua t’i pasuroj ato. Dua të luftoj rektorët, dekanët dhe botuesit me fizionomi të qartë paleolitase, të cilët iu prezantojnë akoma sot konkurentëve të ciklit universitar, teste me pyetje nga lufta Nacional-Clirimtare dhe Konferenca e Mukjes. E tmerrshme dhe e pabesueshme për vitin 2005!

Po, po, dua “t’i dënoj me vdekje”, jo ata, por mësuesit e fillores që iu dhanë atyre dëftesën. Kuptohet, virtualisht dhe kjo ndodh në mungesë, për arsye të moshës së mësuesve mëkatarë, shumica e të cilëve nuk janë gjallë. Dua në këtë mënyrë, me luftë të përditshme dhe serioze të luftoj dualizmin e gjallesave njëqelizore të sistemit (shkrimtarë, publicistë, diplomatë) që bëhen gjithmonë dhe në çdo rast, “më katolikë se Papa”. Dua që me luftë, konceptesh natyrisht, të futen nëpër tekstet shkollore veprat më të larta të shqiptarëve, të shqiptarizmës dhe mendimit akademik botëror. Dua ujë të pijshëm, të pastër, me shije, të freskët dhe të rrjedhshëm. Nuk dua erë të qelbur paqeje postkomuniste.

Dhe për këtë preferoj luftën, djepin e institucioneve dhe rregullave shoqërore. Do preferoja të shihja “gjak” fajtorësh (virtualisht për të shprehur etjen për drejtësi) dhe jo fekale, sepse sigurisht gjaku do të ngjallte pasionin dhe vlerësimin e gjërave tek njerëzit.

Në kohë lufte rrjedh gjak e në kohë paqeje derdhet m..!- thotë ai mjeshtri metropolitan.

Zgjidhni e merrni midis jetës plot dinamizëm, me “luftë” dhe përgjegjësi ose erës së qelbur dhe jashtëqitjes kolektive që krijon “paqja” vegjetuese.

** Ua dedikoj këto vargje të gjitha "larvave" njëqelizore që duan të uzurpojnë hapësirat e jetës publike dhe istitucionale.*

POLITIKANET E "REPUBLIKES SE DYTE"

Ata të vegjël,
ishin dhe mbetën,
pa dashuri,
pa ditur not.

Dhe biçikletën
kur e mësuan,
iu duk se qiellin
prekën me dorë.

Adoleshencën
dot nuk e njohën
se deshën, u bënë,
të "rinj militantë".

Edhe në banjë thoshin:
"Rroftë Partia!"
"Partia më rriti,
paçka se kam nënë".

Të parët në shpifje,
kritika pa vend.
Presionet, dredhitë
i njohën shumë shpejt.

I vunë në jetë
në shërbim të vetvetes,
me emrin "Parti"
mbijetuan të padrejtë.

Ky ishte modeli
i errët që pengoi
zhvillimin dhe ecjen
përpara tek ne.

Nga ferri ata dolën
dhe prapë do rihyjnë
bashkëkombasit tanë,
njerëz të pavlerë.

Të squllur, të zakonshëm,
pa ndjenja dhe pa gjak
si gjarpërinj, të zvarritur,
kërkuan terren.

Çdo gjë me këmbë
shkelën pa patur ideal
u çorrën u përdrodhën,
në politikë për karrierë.

Me vajzat moshatare
që bukur hidhin shtatin,
mendonin!.. bënin plane!..
se si t'i rekrutonin

dhe jo t'u jepnin shansin
këmishat të zbërthenin,
që femrën brenda tyre
ta njihnin, ta zbulonin.

Se duhej u martuan,
për ta ish detyrim.
Askush nuk mund t'u thoshte:
"Nuk dua, nuk më ngjit!"

Për gra morën ca "pengje"
që kurrë s'i lanë të flisnin,
të cilat veç fëmijëve
nuk patën dot gëzim.

"Karriera mbi të gjitha!
Të bëjmë politikë!
Gjithmonë me shpirt proteste"
premtime! Vidh e shpif...

Këtu gjithë universi
i njerëzve pa moral
vërtitej rrotullohej...

gënjeshtra për publik!

E shoh çdo gjë të errët
me këta që nuk jetuan
siç duhej dhe shpresonin
rininë, adoleshencën.

Kërkojnë të shiten "engjëj"
ndërkohë që s'dinë të krihen.
Veç vjedhin, marrin, zhvasin
pa prishur "etiketën"!

E ç'mund të presë prej tyre
një shoqëri që ndjek
modele bashkëkohore,
dhe drejt Europës rend!

Mendoj t'u japim rastin
të shkojnë të rigjejnë veten
sidhe rininë që humbën
aq turpshëm "Fletërrufeve".

T'i nxjerrim të paaftë
në mendje dhe në vepra.
t'u themi se vlejnë veç
në vreshtë si dordoleca.

Këta që baballarëve
"zanatin" shpejt rrëmbyen,
Shqipërinë në "republikë
bananesh, kurvash" kthyen.

U rritën kafeneve,
"politikanë të rinj"
-"Nga vjen ti mik vëllai?
-Unë jam ish-sigurims".

Kështu të gjithë me rradhë
me "ish" përpara janë
njëri ish-zetorist,
tjetri me kontrabandë.

“Oburra të bëjmë qejf!
Askush nuk merr vesh gjë.
Të marrim sa të mundim,
aty ku nuk mban më.”

Po pse mor shpirt njeriu
të duket legjitim
zakoni i hajdutit
në vendin tim martir?!

Martir i injorancës
së baballarëve tuaj
që shqelm i dhanë kulturës
“për t’u emancipuar”.

Dhe hodhën Mbretërinë
me formë “demokratike”
me gjak dhe kokë shqiptari
“për ligje republike”.

Po, republikë tiranësh
ku mbijetoi krimi,
horllëku, servilizmi
spiuni, operativi.

Pastaj e morët juve
si djem me prespektivë
nga “republikë e parë”,
në “republikë të dytë”.

E qatë me lot të shkuarën
por forca gjetët prapë
të hidhnit baltë mbi Kombin
që nuk ju nxorri jashtë.

Jashtë them si jashtëqitje,
si eskrement social
si të pamerituar
si meshkuj të përdalë.

Mendoj miq fund t’i japim
tragjedisë shqiptare.
T’u nisim pa shumë zhurmë

proçes të pastër fare.

Dhe jo për "kafe e perde"
siç bëri "prokurori",
në vitet e lirisë
kur shahej diktatori.

Pra llogari të japin
për vete dhe të tjerë
pse botën prapa kthyen
na mbajtën në skëterrë.

E di nuk është e lehtë
të mposhtësh ca harbutë,
si këta që shpirt shejtani
kanë brenda nën lëkurë.

Dhe fe e Zot nuk kanë,
s'ju duhet, s'ju përket.
Iu falën Francës plakë
dhe hodhën besë e nder.

Por gjithsesi në fund,
të gjithë me kokën lart,
shpëtim të madhit Zot
kërkojnë dhe pse s'kanë shans.

**Edhepse askush nga ne nuk mund të japë verdikte mbi mundësinë e gjithsecilit për të kaluar në Dashurinë e Zotit, me mënyra figurative, theksohet gjendja e pashpresë në të cilën ndodhen ata që kaq shumë i kanë ushqyer flakët e ferrit me mëkatet e tyre.*

Itali, 25 janar 2005

BORGJEZI, NGRIJE PAK KOKEN

Qytetarë e katundarë
para s'kanë e llafe bëjnë
pa menduar se një ditë
do t'u duhet të jetojnë.

Të jetojnë, por jo si dele,
të kuptojnë se janë me fat
që "plugojnë" vendin e vjetër
ku ngroh dielli në çdo prag…

E sokak ku filli mbeti
si lum ne për këtë vend
bosh hambari, qan buxheti,
futja kot e shit pak mend.

Mendje shesin pa parë mbrapa
pa marrë fare në kujtesë
si u rritën kokëulur
në dekada pa protestë.

Me sllogane mbushin shpirtin
shpresën poshtë s'e lenë të bjerë
punë të ndershme s'dinë si bëhet
shesin blejnë "miell-piper".

Presin ç'do t'u vijë nga lart,
nga "Ai", "Ata", "Ato",
që premtime shumë u bëjnë
pa iu a dhënë të shtrenjtën tokë.

Fjalët si "liberalizëm",
"bashkëjetesë", "qytetërim",
nuk na i mësuan cubat
që drejtojnë klanet-parti,

Nuk na i solli as reforma
me të pakënaqurit e vet
por na i serviri koha
që nuk hesht dhe dot nuk pret.

Jo, nuk pret. Ta themi drejt.
Koha është mësuesi i madh,
të gjithë nxënësit e saj i vret,
duke ecur i lë pas.

Pra ta marrim pak më shtruar
se nuk bëhet me të sharë,
nuk del dot në pah e mira
me luftë "trimash" provincialë.

Se për mua "trim" i thënçin
Vetja kujt i hyn në qejf,
harron kur, nga dhe si erdhi
fshatin la për në qytet.

"Thjesht për modë duhet të ikim!
Shtëpitë të shesim, benz të blejmë.
Duke lënë çdo gjë që kishim
të ndryshojmë identitet."

Të punosh tokën e babës
punë e bukur është sa s'ka
por zanatin askush tjetër
s'e njeh mirë si ti fshatar.

Ti që ndoshta libra s'shkrove,
buxhet shtetin s'njohe dot,
hero, mit në shekuj mbete.
Besën, tokën mos lësho!

Sepse toka e begatë
në një vend që gjelbëron
të jep shkak të vrasësh mendjen
të rrosh mirë e të votosh.

Të votosh ama, jo tjetër!
Jo të shkosh të japësh mend
se padashje ndryshon udhën
përfundon në Parlament.

Përfundon në Parlament

ti o nipi i Rapsodëve,

ti që tokën, delet, këngën,
ëndërroje por tradhtove.

Na i le pa zot, pa shpresë
për Tiranën që s'e njeh,
që s'është më ajo e para
dhe që s'ka më Burra Pleq.

Burra pleq që japin mend
edhe vendin i lënë djalit
kur e keqja vjen afrohet
nga kufiri përmbas malit.

***

Pra për mua një gabim
Shumë të madh e bëmë të gjithë
unë i pari në mërgim
bashkë me ty që shite dhitë.

Ndryshuam vendet e lojës
që nuk njihnim. Ah sa keq!
Ti e le fshatin në pritje,
unë e lashë qytetin shkretë.

Edhe unë njëlloj si ti
çoban gjysh a stërgjysh kisha,
rapsodi të bukura di
ndaj bari mendjesh u rrita.

Ky ka qenë sekreti i madh
që i madhi gjysh më la:
"Ajër të pastër e ujë të mirë
do njeriu për ortak.

Pastaj punë përditë nga pak
ose shumë sipas vullnetit.
Nuk pa kush ëndrra në gjumë
dhe u gjend papritur çelsi".

Vatra plot e mendja plot
vjen nga puna, toka, dija.
Hiqni dorë nga rrugë e shkurtër

Krimi! Mafia! Pasuria!

Ta gjejmë bashkë mes nesh të mirën
duke bërë një pakt si ky,
ti në fshat të mbash traditën
unë ligje të bëj për ty.

"Ligje" do të thotë dhe shkollë,
rrugë të mira, shtëpi-hotel,
që të vij tek ti çdo javë
për pushime a për biznes.

Por që të më vish dhe ti
Në të mirë a në të keq,
për t'i prurë qytetit, mua,
trajtë mistike, këngë dhe besë.

Unë për ty para me këste
do të duhet shumë të gjej
nga ty dua verën tënde
qingjin tënd dhe bukë të blej.

Kemi shanse si askush
të ndreqim punë e biznese,
mos ta blejmë më shtrenjt se frëngu
kosin turk e verën greke.

Ti fshatar, që mbrapa mbete
tek kërkove ta provosh,
lëre punën e shejtanit
ktheju tokës, rrit ca lopë.

Jo për të më lënë të qetë,
por për të jetuar mirë
ti i pari si dikur
zot i tokës, bujk fisnik!

Pa ia ditur për nder "Miqve"
as "Doktorëve" natyrisht,
duke parë më larg se vetja

të jetojmë qytetarisht.

Jo patjetër në qytet,
që t'i vemë kazmën çdo gjëje.
Le të kthejmë pak sytë nga fshati
që dhuron burime jete.

Kjo do donte si fillim
"grurë" të mirë, "kope" të mbarë
për t'ia dhënë fjalën së fundmi
atij të mençurit "bariut plak".

Qytetarë e katundarë
më i mirë njëri nga tjetri
që u shkulët me taban
për t'u kthyer këmbëpërpjet'thi,

mos harroni se kurbeti,
në Tiranë a matanë detit
nuk vlen kurrë sa vendi i lindjes
dhe kur ky është më i keqi.

Për që tokën ka lënë djerrë
them t'i verë pak gishtin kokës
nuk do rrojë sa një shqiponjë
për të parë çuditë e botës.

Ndërsa ti "zengjin i ri"
që makinën lan përditë
dije mirë se dritë e mendjes
do shumë libra… e zor të vijë.

Mos e shih si pikësynim
katin e lartë të një pallati
që ndërtoi fshatari "trim"
për të ngritur pak standartin!

Fute dorën thellë në xhep,
jo për të paguar birrat,
as për benzin tënd të shtrenjtë,
por për të dhuruar libra.

Se pa librin or i mjerë
paratë do t'i humbësh shpejt,
do hash e do pi pa masë
e si do doje kurrë s'do jesh.

***

Në këtë botë ku mirë jetohet
Gjithsecili bën të vetën,
ndaj ta kthejmë kokën nga duhet
dhe të gjejmë të vërtetën.

Për ata që më kuptuan
dhe "për nder"-më thanë-"ta dimë",
vështirësia është tek vota
tek kjo kuçka qelbësirë.

Na tradhton dhe ne ia dredhim
në çdo rast që zgjedhje bëjmë.
Një parti të re kësaj rradhe
më dëgjoni, vetë ta ngremë!

Një parti të qytetarëve
që për vete s'duan shumë,
pak për fshatin të mendojnë
dhe për Kombin që fle gjumë.

**Atdheu, djepi i ëndrrave tona, motivi i sakrificave, altari i shenjtërimit të idealeve, kërkon nga ne kthjelltësi mendore, kulturë dhe identitet të qartë shoqëror. Eshtë thelbësore që çdo shtetas, fshatar apo qytetar qoftë ai, me dinjitetin që meriton dhe jo me kriterin e një barazie false, të gjejë vendin e tij natyral në jetën komunitare. Vetëm atëherë, kur ky objektiv të arrihet, shoqëria mund të funksionojë si një organizëm perfekt dhe i harmonizuar.*

shkurt 2004

Në memorie të protestës së dhjetorit 1990

KENGA E LIRISE

Renda i ndrojtur nëpër botë
për të gjetur shpresë dhe paqe
kokën kthyer mbajta gjatë
pa e humbur shijen tënde.

Tokë e pastër nga mëkatet
mbushur plot me mëkatarë
mbyllur mban sekretin plak,
që na shtyn, na hedh shumë larg .

Si vegim n' atë vrull rinie
kur veç dritë yjesh ne shihnim
erdhe ti e freskët, befas,
tek nuk pritej, nuk të njihnim.

Të kërkonim nëpër ëndrra
tentativa plot rrezik,
dëshëronim të të kishim
si çdo vajzë që zbardhet dritë.

Dorën zgjate më në fund
një ditë dimri, ledhatove,
shumë prej nesh
që shumë të donin,

dhe i more iu rrëfeve
vende, ngjarje, horizontin…
udhën tënde prej nga erdhe.
Veshe petkun e dhjetorit

Ti e vetmja gjë që s'vyshket,
ti Liri që vonë u shfaqe,
Krahë-hapur, plot me ngjyra
si një lule në mes njerëzve.

Më rrëmbeve dhe desha
larg qëndruam si të etur,
ndaj gjithmonë betuar duket
jam që kurrë pa ty t`kem mbetur.

Sepse më ringjall heronjtë,
që tek ty mbështetën shpirtin,
për të parë ditën e festës
sytë e tu, Lirinë që prisnin.

Ti jetoje tek të tjerë,
që nuk flisnin gjuhën time.
Sa do doja t'i tundoje
këta që frikë të kanë dhe dridhen!

Dhe t`na vije si atëherë
kur e bukur shend e verë,
ti më e madhja mike e shtrenjt,
madhështore ndër këto vise.

Ku veç djemtë nuk munguan
për t'u bërë martirë të tu't,
"Kalorës Drite të Lirisë"
Sot rapsodi këngë iu thur.

Se me emrin dhe për emrin
tënd të vetëm që s'e ndanë,
me një hov të parrëfyer
u betuan, jetën dhanë.

Liri!
Me krahë të gjatë,
të hijshëm në të cilët
shpesh përhumbem
unë me ty.

Duke pritur të mahniten
dhe ata që larg si yll,
dritën ndjekin pa u ndalur,
gati zemrat hapur mbajnë

se të duan me çdo çmim
e sot ende nuk të kanë,
për të qënë të lirë si ti
si heronjtë në përjetësi.

Dedikuar Poetëve, Luftëtarëve, Heronjve,
të cilët vetëm ata për lirinë mund të flisnin,
por për atë dhanë jetën.

Itali, dhjetor 2004

"un" DHE DASHURIA

E kam të nevojshme sot të them se "un njeriu", ai i përditshmi lajkatar, gënjej kur them pa kandar "të dua". Jam një tinzar i vogël dhe i dobët çdo herë që i them dikujt për të cilin ndjej zili: "të dua". Un, atë ndaj të cilit ndjehem inferior, në mënyrë hipokrite mundohem ta afroj duke i thënë "të kam mik... unë të dua!". Por ndërkohë, "un" njeriu pa shkëlqim, i zakonshëm, i mërzitshëm dhe pa ndonjë inteligjencë të spikatur, nuk di *të dua*.

Ndjehem keq kur kam përpara *inteligjentin e dashur* , "atë pasqyrën" ku shihem dhe më kujtohet që nuk kam lindur në të njëjtin vit me të. Më kujtohet se nuk kam lindur në të njëjtin qytet apo pallat me të, por diku në provincë, apo në ndonjë fshat të harruar. Nuk kam emrin dhe historinë e tij, idetë e tij, botën shpirtërore apo atë botë miqësore të tij. Nuk e pashë dhe nuk e gëzova dot të njëjtën *dashuri* që mori si dhuratë në jetën e tij ai tjetri.

Kështu gënjej edhe kur i drejtohem ndonjë vajze të cilës i them "të dua". Në të vërtetë "un" atë vajzë nuk e kam objektiv dhe destinatare të ndjenjës time më të madhe. Nuk i jap asaj çdo gjë. Nuk i jap shpirtin dhe energjinë e madhe që del prej tij. "Un", si lajkatar, ziliqar dhe egoist, i vogël dhe mizantrop, *dua prej saj* atë çka më intereson tek ajo, por nuk *e dua atë*. Pra "un" nuk i jap asaj dashuri. I jap asaj vetëm materie të rrjedhshme ose para, instikte dhe fjalë të bukura spekullative që janë në inflacion, përralla, gënjeshtra e plot të tjera si këto.

E atëherë më lind pyetja: Po çfarë *dua* "un" ndaj këtij personi? Cfarë kërkoj "un" nga njeriu. Atë që s'e kam?! Atë që s'mund ta kem?! Të *kaluarën dhe shpirtin* e tij!

Përgjigja më vjen e rrufeshme. Jo. "Un" nuk e *dua* atë. "Un" dua me të padrejtë atë që s'e marr dot, atë që s'është e imja, atë që s'kam për ta patur kurrë. Kështu si rrjedhojë nuk *dua* por *lakmoj*. Ky është verbi i përshtatshëm: *Lakmoj*. Jo *Dua*. "Lakmoj dhe kam zili"- kjo është motoja jonë e përditshme katastrofisht penguese, e cila në mënyrë të pavullnetshme, me forcën e saj negative, më bën të më errësohen sytë dhe jo rrallë t'i dua të keqen *atij* tjetrit. Dua që gjërat dhe dhuntitë që ai zotëron t'i nënshtrohen *dëshirës* por jo *dashurisë* time. Jam egoist dhe vanitoz ndaj tij. Dua për vete edhe pjesën time, por mbi të gjitha atë çfarë ka të mirë e të shtrenjtë "ai tjetri".

Sepse unë jam "un". Egoist. Për mua bota fillon dhe mbaron tek "un". Cdo gjë tjetër, duhet të më shërbejë mua dhe egoizmit tim.

Kështu Dashuria, ndjenja më e madhe dhe më e bukur ndër njerëzit, përballet me veset dhe mëkatet tona, por edhe me parregullsitë e fjalorit tonë.

"Un *Dua"* në sensin që: *Kam nevojë*. Po, "*kam nevojë"* është gjetja tjetër për të qënë sa më korrekt në përdorimin fjalëve, pa thënë abuzivisht "*dua"*. Por, këtij konstatimi, pra shprehjes *"kam nevojë"* i shtohet pjesa e dytë dhe më e errët e ndjesisë. I shtohet fakti se pasi "*kam nevojë*" për dikë, dua ta shoh poshtë këmbëve të mia pikërisht atë të cilin un e lakmoj dhe që faktikisht nuk e dua.

Duhet në këtë kontekst pra, të rregullojmë para së gjithash fjalorin tonë të përditshëm përveçse udhës së shpirtit, për të mos u keqkuptuar sistematikisht nga dhe me të tjerët. Sepse kemi një jetë të tërë që gënjejmë dhe krijojmë iluzione duke thënë "*e dua atë"*. Atë që më shkakton traumën e fortë të inferioritetit. Atë që "*un*" s'jam dot. Në këtë rast kemi të bëjmë me një ndjesi tjetër dhe aspak me *dashurinë*. ***"Un***" kam nevojë për atë por nuk e *dua,* nuk e *dashuroj* atë. Dashurinë nuk e njoh akoma, në kuptimin që nuk arrij ta perceptoj këtë ndjesi që ndoshta ekziston brenda meje. Me shumë probabilitet ajo, *dashuria,* ekziston brenda "*meje*" për faktin se edhe "*un*" jetoj dhe jam krijuar të jem në mes njerëzve, të cilët vazhdojnë të riprodhohen prej *dashurisë…* Por për ta gjetur, më duhet ta kërkoj *dashurinë* në thellësitë e shpirtit tim, ndoshta edhe duke ia drejtuar thirrjet për ndihmë *Dikujt* tjetër.

Dashuria vuan edhe verbërinë tonë.

"*Unë*" njeriu i vogël, i rritur me *dashuri* sigurisht, sepse pa këtë sentiment energjik nuk do mund të vazhdonte jeta, vdes çdo gjë, ndoshta nuk e kam ndeshur kurrë atë. Ndoshta nuk e kam njohur dhe shijuar kurrë të vërtetën e madhe, kushtin bazik të ekzistencës time, *Dashurinë.* Kam frikë dhe më duket sikur flas për diçka të largët, për diçka që s'më përket, por në të vërtetë unë jam i ushqyer prej saj, me diferencën e vetme se nuk e kam parë kurrë me sytë e mi të etur e të mbyllur. Nuk e kam prekur dot personalisht me ndjesitë e mia që janë të zbrazëta pa *të*. Në rastin *"tim"* fatkeq ajo, *dashuria*, më ka adoptuar në distancë dhe më ka rritur pa m'u shfaqur. Më ka ushqyer në errësirën dhe verbërinë time. E pikërisht, për shkak të kësaj vuajtje e boshllëku materialist të cilit s'ia gjeta dot burimin, nuk u rrita i lumtur.

Kështu, nuk e "kam njohur" as në fëmijërinë "time" *dashurinë*. Nuk e kam njohur as në adoleshencë, as në familje, as në fshatin apo qytetin "tim", por për të kam dëgjuar pa fund, pa e kuptuar kurrë se për çfarë bëhej fjalë. Deri sa një ditë, në vitet e para të

pjekurisë, disa mësues filluan të më flasin më me intensitet për këtë sekret të madh. Filluan të më flasin e të më imponojnë bindjen: se *mbi bazën e çdo gjëje jetësore është dashuria*. Që atëherë, kam filluar të flas edhe unë për *dashurinë*, por me pretendimin tim egoist, ziliqar dhe materialist nuk mbaj mend ta kem takuar ndonjëherë.

*Pa *dashuri*, disi i verbër, i çrregullt në idetë dhe dritën e mendjes "time", paqen dhe qetësinë e humb shpesh. Drejtësinë nuk e eksploroj fare si mekanizëm të domosdoshëm për të ndërtuar *Paqe* e *Dashuri*. E këtu ngre shpesh herë kokën lart, për të kërkuar *dritën*, duke harruar dhe nënvleftësuar faktin se *drita* fshihet brenda "*meje*", në shpirtin tim. Nuk më lejon egoizmi, kokëfortësia, vaniteti dhe mediokriteti të shoh *dritën* e shpëtimit tim. Si një farë e mbarë tulipani, *Dashuria* fle brenda shpirtit tonë. Ajo pret *Paqen* për të nxjerrë filizin e saj, për t'u rritur e për të dhënë frytet e saj.

Tani, me një copë letër në dorë, që konvencionalisht quhet diplomë, u jap leksione të tjerëve mbi këtë temë, por ndërkohë vazhdoj të lakmoj mikun tim, të njohurit e mi, të panjohurit e mi, kalimtarët e zakonshëm në trotuar. Lakmoj ata që edhepse mbi këtë temë, *dashurinë*, nuk kanë marrë shumë leksione, e kanë njohur atë. Ata kanë jetuar dhe janë dehur me të. E pa *atë* nuk jetojnë dot. Kjo, ndërkohë më bën të ndihem keq, më shkakton frustracione. Në momente të papritura, më kujtohet përsëri fakti se ai tjetri e ka njohur *atë, dashurinë,* ndërsa "*un*" u rrita me një emër që u detyrova ta ndërroj në gjykatë, duke shpresuar se me këtë do gjeja pak *dashuri*. Pastaj më kujtohet se u mundova të shkollohem e u lodha e u lodha shumë, gjithmonë për të gjetur pak *dashuri*. U zhgënjeva edhe prej poezive pa jetë që lexova netëve të gjata vetëm për të gjetur *dashurinë*, atë ndjesinë e mistershme për të cilën flasin të gjithë.

Çuditërisht dashurinë e kishte *"ai tjetri"*, *"ajo tjetra"*. Ata dinin të ecnin në rrugë, të silleshin me njerëzit e të pranoheshin prej tyre me thjeshtësi. Ata rrezatonin mirësi, bukuri dhe estetikë. Gjenin gjithnjë kohë të qeshnin e të donin, pra të dhuronin dashuri. Kurse mua *dashurinë* ma largonte ideja brejtëse mbi çertifikatën time të lindjes. Ideja se "*un*" isha ai i linduri atje larg më shqetësonte, ndërsa ata jetonin të *lumtur*, jetonin me *dashuri* edhepse shpesh disa si "*un*" i pickonin, i lëndonin. Sepse të padrejtët e pafat *kishin nevojë* t'iu merrnin të *lumturve* atë që s'ishte e tyre, pikërisht dashurinë që *ata,* të lumturit, mbanin thellë në shpirt.

Në këtë pikë të *dëshirës ose nevojës së padrejtë të njeriut ndaj njeriut* kanë lindur luftrat, konfliktet dhe njerëzimi është gjakosur keqas. Kjo do të thotë se padrejtësia ka tentuar disa herë të eklipsojë *dashurinë*... Dhe "*un*", pjesa e pavullnetshme e mëkatare e kësaj

padrejtësie, kam rrezikuar disa herë edhe jetën nga turbullimi që kam krijuar tek vetja dhe dhimbja e krijuar tek të tjerë.

Na duket sikur pas gjithë këtyre rreshtave e paragrafëve, kemi futur në një laborator analizash shoqërore gjithë kohët dhe peripecitë njerëzore, gjithë sukset dhe dështimet, gjithë luftrat që kanë lindur nga dashuritë dhe dashuritë që janë ndërprerë nga luftrat.

Dashuri

*do të thotë të *ofrosh zemrën* dhe jo fjalën hipokrite. Do të thotë të *ofrosh shpirtin* dhe jo "*dhurata helene për Trojën*" që vlejnë veç për t'i hyrë sa më thellë në privatësinë e tij "*tjetrit*", për ta sulmuar më pas atë sa më fort.

E kështu vazhdojmë me *buzëqeshjen* si element i rëndësishëm dhe i dukshëm i *dashurisë.*

Mirësia, është edhe kjo pjesa e pandarë e asaj të madhërishmes vlerë absolute, sublimes ndjenjë që quhet *Dashuri*.

E pikërisht *Dashuria*, ky element që vjen tek ne nga *Lart* me një *frymë të pastër qiellore*, na mbush *hapësirën shpirtërore* me *ndjenjën* më të bukur që të gjithë e kërkojmë, e adhurojmë dhe e ëndërrojmë.

Por le t'i kthehemi fenomenit më shqetësues të shoqërisë, mungesës së *sublimimit të dashurisë* nga i dobti dhe i vogli njeri gjatë jetës së tij.

Për t'i dhënë zgjidhje këtij problemi,

na duhet që për të gjetur *Dashurinë,* të verifikojmë gjendjen në të cilin ndodhet *shpirti***,** duke kontrolluar habitatin ku zbret nga *Lart* dhe rritet ky *sentiment jetëdhënës*. Nëse ky *habitat dashuror*, *shpirti*, nuk ka hapësira pastërti, paqe dhe qetësi, atëherë *dashuria* nuk mund të prehet në të. *Dashuria ka nevojë për Paqe që të jetojë e të nxjerrë frytet e saj. Kurse Paqja ka nevojë për të rëndësishmen dhe të domosdoshmen Drejtësi për t'u krijuar.*

Në një shëmbëlltyrë thjeshtëzuese, do ta krahasoja *Paqen* me kushtet ambientale më perfekte. Do ta krahasoja me një lëndinë të bukur shtrirë në një fushë ose kodrinë, ku fryn erë e lehtë dhe e ngrohtë, ku lind dielli që i jep jetë e ngjyra këtij habitati.

Por duhet të kemi kujdes se pa një përkujdesje dhe pa vëmendjen e duhur, pra pa të domozdoshmen *Drejtësi*, në këtë kopsht të bukur *Paqeje* nuk mund të lindin *lule të mrekullueshme* siç është *Dashuria,* sepse mund të ndodhë dhe në fakt ndodh shpesh që në kopshte të bukura lindin *ferra të këqija* të cilat tentojnë ta mbysin *jetën*, *lulet, Dashurinë.*

E "ne", të "përkryerit", " liderët" e mendimit shoqëror, gjatë gjithë shekujve kemi justifikuar errësirën, "ferrat", barishtet mbytëse, të

keqen, duke bërë kompromise në emër të të tjerëve dhe gjoja për interes të tyre, por në të vërtetë jemi nisur nga interesa të ngushta personale, duke mbrojtur dhe interpretuar gabimet, vetveten, të afërmit, miqtë e dashur, pa u vënë aspak në shërbim të komunitetit dhe me sytë nga ***drita e vërtetë****,* ***Dashuria****. Sigurisht kemi vepruar jo drejt.*

Pra, na duhet Drejtësi dhe vetëm Drejtësi për të ndërtuar Paqen, e cila do të na japë mundësinë dhe kushtet për rritur dritën e Dashurisë që ne të gjithë mbartim si dhuratë nga Zoti. Dashuria fle tek gjithsecili nga ne, me diferencën që në kushte paqeje ajo del e triumfon mbi hapësirat njerëzore e në të kundërt, në një terren konfliktual, ajo që dominon është e keqja, errësira, gjakosja.

Dashuria do triumfojë sigurisht, por vetëm në kushte Paqeje, e cila ka nevojë për Drejtësinë…

Duke mbërritur në këtë pikë them se nevojitet inteligjencë, forcë shpirtërore dhe ndërgjegje për të kërkuar Drejtësi, e cila na bën të gjejmë Paqe dhe të jetojmë njerëzisht në Dashuri.

Me këto kolona orientimi jo fort të promovuara në bulevardet e jetës "moderne", do të kemi më pak gënjeshtarë, ziliqarë, lakmitarë, vrasës, hajdutë, katundarë praparendës, pseudo intelektualë e të tjerë si këta…

do të kemi më shumë mbrojtës të së vërtetës, dashamirës, bamirës, qytetarë model, ndërtues katedrash, nëna *materne me dashuri për të riprodhuar jetën* dhe ambientalistë të kulturuar që jetojnë në fshat për zgjedhje. Sigurisht do të kemi edhe më shumë njerëz të qartë në mendime.

E pikërisht për këtë domozdoshmëri në qartësinë e mendimeve, nuk do të hezitoja të përsërisja citime gjeniale thënë nga njerëz të mëdhenj:* ***Dashuria eshtë forma më e lartë e Inteligjencës Njerëzore!***

Kështu pra, na jepet mundësia të arsyetojmë se, si rrjedhim:

Dashurinë mund ta njohë dhe ta prekë vetëm njeriu inteligjent me shpirt të pasur e të pastër, jo detyrimisht i shkolluari mediokër që mban në dorë tituj të stampuar nëpër letra, që sot quhen diploma dhe rezultojnë të firmosura nga mediokër të tjerë.

p.s.

Tani së fundmi dua të them se, në këtë përpjekje analitike, ai i cituari "*un*" je ti, kushdo qofsh e i kudogjendur, kurse në rastin e

"*atij tjetriť*" shpesh herë kam qënë unë personalisht... e duke u ndjerë i keqardhur për situata të tilla të përjetuara jo mirë, jap si zgjidhje:

Drejtësinë, Paqen, Dashurinë… që arrihen me besim, inteligjencë e vullnet dhe jo me budallallëk, egoizëm, zili e vanitet.

VELLAI I POPUJVE-KALORESI I BARDHE

U ule në gjunjë
puthe tokën time*
o Ati i Shenjtë
o Vëllai i Madh.

Tokën e martirëve,
idhtarëve të Krishtit
e puthe në zemër,
shërove ca plagë*.

Me popujt marshove
drejt rrugës së paqes,
në njerëz dhe shpresën,
iu fale Liri.

Fluturojnë zemrat,
lotët mbysin fjalët
të gjithë të përcjellim
në të Kaltrën Mbretëri.

puthe tokën time*-*Ati i Shenjtë, Papa Gjon Pali II, me ardhjen e tij në Shqipëri në vitin 1993, sapo zbriti nga avioni me të cilin udhëtonte, u ul në gjunjë dhe puthi Tokën Shqiptare.

e puthe në zemër,
shërove ca plagë*- *Në atë vizitë, Ati i Shenjtë i ftoi shqiptarët të kërkonin paqen brenda tyre dhe të shmangin urrejtjen e klimën konfliktuale që rrezikonte keqas shoqërinë. Kjo ftesë për paqe u ofronte individëve dhe grupimeve që vuanin nga plagët e krimeve të të sapodështuarit rregjim komunist, një optikë të re mbi të ardhmen, e cila kish nevojë të domozdoshme për t'u rindërtuar mbi parime njerëzore. Papa Gjon Pali II me xhestin e tij të puthjes së tokës u ofroi dhe u rikujtoi shqiptarëve, sekretin universal të paqes, dashurinë, e cila shëron çdo plagë.*

Tiranë, 3 prill 2005

FLOKVERDHA!

Me emrin e saj
që bën të zbardhë drita,
ashtu kaltërore,
shpresoja ta gjeja

dhe vjen shtojzavallja
e bukura, e mira
me flokët e verdha
me buzë të rubinta.

E dija, e prisja,
ajo më priste mua,
pa ditur se kur
nga ëndrra do dilnim,

m'u shfaq engjëllore
kur e gjeta tek qeshte,
me dhëmbë të fildishtë
si një kallzë gruri.

E bukura, e mira,
ajo shtojzovallja,
e dashura ime
që Qielli ma fali,

më do dhe e dua
si sytë, si floririn,
atëvet perfeksionin
që ka emër ylli.

DASHURI E KALTER

Sigurisht do doja
me Ty shpesh të flisja
pa dyshim mbi gjërat
që i di veç Ti.

T'i mësoj të gjitha
pa mbarim të gjitha
Zot i Kaltërsive
Dashuri pa fund.

Të jem gjithmon zgjuar
në kurriz të natës
të takoj mëngjeset
dhe diellin që lind.

Diellin thellë prej zemrës
zjarr dhe dritë për njerëzit
nxorre ti dhe hënën
e mërzite shum.

Ajo kërkon yjet
në natën e errët.
Vajza jetë prej syve
jep në përmallim.
***
Pa kufij të bukura
me naze dhe forma
i krijove enkas,
lot u dhe të qajnë.

Qajn prej xhelozisë
pse me errësirë
ua dhurove fatin
diellin bëre djal.

Bukuroshe hëna,
vajza zan dhe lule.
Të dyja sëbashku
nusërojn dhe ngjajn.

Vajza këndon djalin
dhe i mburret hënës
pse Zoti i fali
fryt, mister në shtat.

Lozonjarja e natës
Diellin pret mbas muzgut
që asaj nga vetja,
jetë dhe dritë t`i japë.
***
Mi trego të gjitha,
pa mbarim të gjitha
Burimi i Ujrave
Energji që s'humb.

Hënën, lulet, vajzat,
i bëre të bukura
porse delikate
mbeten deri në fund.

Zot i dashurisë!
Ti që fusha e male
vajzat, djemt, livadhet
i deshe aq shum,

thuaj pse ma vure
këtë peshë të madhe
gruan dhe mëkatin
t'i mbaj vetëm unë.

MBI MIQESINE

Mbi miqësinë është thënë shumë

e un tani dua të flas për diçka të madhe, vërtet të madhe. Dua të shndërroj përpjekjet njerëzore në një sado të vogël qartësi mendimi mbi atë që *de facto* merr vlera shpirtërore dhe bëhet miqësi.

Sigurisht, "duhet të kemi brenda qënies tonë piksëpari virtytin, që më pas të kemi mundësi të realizojmë miqësinë e vërtetë"-thotë Ciceroni. Ky rrëfimtar romak, esseist, filozof, pra njeri i mençur dhe shumë i njohur për katedrat e mendimit, jetoi deri pak përpara epokës së Krishtit, rreth 40 vjet përpara daljes së profecisë nga misteret Hyjnore. Ai, i shqetësuar thellësisht nga ecuria e treguesve shoqëror dhe politik të kohës, fillon e na tregon modelin e miqësisë dhe forcën e saj si element garantues për një rend shoqëror me themele të shëndosha.

Duke u kthyer tek e përditshmja jonë, ose tek shekujt që kanë kaluar, ku me termin miqësi është abuzuar pambarimisht, them se miqësia është një virtyt dhe kusht në të njëjtën kohë. Ajo është kusht që për ta patur si virtyt, duhet të përzemë nga brendia e qënies tonë hipokrizinë, zilinë, interesat materiale, karrierizmin, servilizmin. Po të zëvendësonim gjithë këto vese të urryera që mbart shpirti dhe mendja njerëzore me miqësinë, atëherë do kuptonim lehtësisht atë çfarë ka thënë Ciceroni.

Po kështu do kuptonim më qartë atë çfarë u tha Jezu Krishti Apostujve me frazën: "Duajeni njëri-tjetrin siç ju desha unë juve!" Ai foli për dashuri, por kjo ishte një dashuri miqësore, vllazërore në kuptimin simbolik të shprehjes.

Pra, këtu kuptojmë se cilat mund të kenë qenë rastet e mirfillta kur raportet njerëzore janë karakterizuar nga një ndjenjë e vërtetë miqësie.

Grekët e vjetër, të cilët falë gjuhës dhe shkollave që administronin në gjithë Mesdheun 2000 vjet kaluar, qenë të parët që shkruan libra me Tekstet e Shenjta, sigurisht në gjuhën e tyre mrekullisht të pasur. Pikërisht në këtë gjuhë ata marrdhënien e Jezusit me Apostujt e përkufizuan me termin *philia* (dashuri miqësore). Ndërsa dashurinë trupore, dëshirat atraktive i përkufizuan me termin *eros* (dëshirë trupore). Po ata, grekët e vjetër, të ditur dhe të ndjeshëm siç ishin ndaj të bukurës, gjetën fjalën *agape* (dashuri me frymëzim hyjnor) për më të bukurin sentiment, dashurinë, fjalë kjo që përfaqson dhe kulmin e inteligjencës dhe të ndjeshmërisë tek njerëzit.

Mirëpo, në vakumin e përditshëm shpirtëror, kulturor dhe informativ që përjetojnë njerëzit prej mijra vjetësh, bien shpesh herë pre edhe shumë nga ne. Mundohemi të shprehemi e të komunikojmë dhe kështu s'bëjmë gjë tjetër veçse delirojmë e tentojmë në marramendje të prekim tema delikate por udhërrëfyese për njerëzimin, siç është edhe argumenti: *miqësia.*

E kush nuk shkroi për *miqësinë*?! Barinj, kalorës e kallajxhinj. Luftëtarë, të burgosur e marinarë. Ushtarë, alkoolistë e homoseksualë. Poetë, shkrimtarë, kanunxhinj e tradhtarë... Kumarxhinj, virgjëresha, adoleshente, gra në moshë, prostituta e kështu me rradhë...

Çlirim i pallogaritshëm energjish dhe emocionesh, shpesh herë të hedhura dëm mbi faqe letrash e librash anonimë, të cilët të përdorur ndryshe, padyshim do kishin vlejtur për diçka tjetër, shumë më të dobishme për njeriun.

Eshtë përkufizuar ajo, *miqësia,* në të gjitha format, me shumë fjalë e rreshta, që në pjesën më të madhe të rasteve kanë krijuar konfuzion dhe jo qartësi.

Po në të vërtetë çfarë është ajo?!

Ajo, *miqësia*, është diçka krejt tjetër nga marrdhënia obsesive kundruese që ka, jo me ty por me trupit tënd, homoseksuali i rradhës kur shtiret si mik. Ky raport, ose sentiment njerëzor, si na pëlqen shpesh ta quajmë, *miqësia*, nuk mund të jetë veçse një kusht ku nuk ekzistojnë si referencë të mirat materjale dhe shkëmbimi i tyre mes individëve.

Ai është një raport i kushtëzuar nga fakti se askush nuk mund t'i imponojë palës tjetër "respekt" autoritar. E njejta gjë mund të thuhet, pra në formë kritike, nëse dikush pretendon të përfitojë prej dikujt diçka dhe jeton me paturpësi duke thënë se ndjehet mirë që po përjeton një "miqësi" të tillë. Në këtë rast kemi të bëjmë me një përfitues të rastësishëm që nuk stepet së gënjyeri dhe shtiret si mik.

Jo! *Miqësia* është një sentiment. Ajo, pfilia, është një nga tri elementët ose format ekspresive më të përmendura kur flitet për ndjenjën më të lartë dhe sublime që karakterizon njeriun, pra për *dashurinë*. Miqësia është pjesë e rëndësishme ose shpesh pararendëse e *dashurisë*. E për *dashuri* kemi parasysh atë që përmendet në librat e shenjtë, lidhjen e madhe erotike, miqësore dhe shpirtërore ardhur nga Zoti (Shën Pali Korintasve 1)...

Po t'i flisja të gjitha gjuhët e njerëzve dhe të engjëjve,
po të mos kisha dashurinë, do të isha porsi bronxi që kumbon..

Po ta kisha dhuratën e profecisë e t'i dija të gjitha misteret
e të gjitha dituritë;
edhe po ta kisha fenë e plotë, me të cilën t'ua ndërroja vendin maleve, po të më mungonte *dashuria*, s'do të isha asgjë!...

Kështu, do të shprehesha edhe unë në lidhje me miqësinë ...

po të kisha çdo mundësi materiale ose gjithë hirin e bukurisë;
edhe po të kisha gjithë pushtetin tokësor dhe prepotencën e një qënieje symbyllur që kërkon të barazohet me Atë që e ka krijuar,
po të mos kisha *miqësinë***,** jam i sigurtë se do të ndjehesha i vetmuar e do isha akull i ftohtë !

Vlen të kujtohet se *miqësia* është ajo e painteresuara ndjesi mbi baza materiesh.Ajo e painteresuara ndjesi dhe veç e ndershme ndaj nevojtarëve. Eshtë për ata që e kërkojnë pa interes dhe me sinqeritet atë. Eshtë ajo ndjesi që kërkon dhe i ofrojmë atij që në heshtje e me sjellje dinjitoze ka nevojë për të, për *miqësinë* tonë. Ai e kërkon dhe nuk çirret apo serviloset për ta patur atë prej nesh. Ai nuk na thur lavde, këngë dhe poezi për të na shprehur domozdoshmërinë e të qenurit mik me ne. Ai na e trasmeton ose na e kërkon atë qartë dhe me modesti. Ky pra është miku ynë. Ai na jep të kuptojmë se çfarë kërkon prej nesh dhe na bën që ta ofrojmë edhe ne vetë këtë sentiment, *miqësinë,* tek ai ose tek të tjerë.

Miqësia flet mbi të gjitha me veprime miqësore, me fjalë e me sy miqësorë. Ajo nuk ka sy të lëngët plot me dëshira trupore. Nuk ka sy hulumtues, dinakë e të lëvizshëm, për të zbuluar hapësira përfitimi tek "miku" i rradhës ose komoditete rrethanore në habitatin e tij.

Ajo, *miqësia,* nuk ka brenda strukturës së saj strategjira okulte mbi depersonalizimin e atij që duam ta kemi mik, duke i shkaktuar atij trauma, duke i prishur atij ekzistencën prej xhelozisë, duke i shkatërruar raportet që ai ka me të tjerët dhe me gjithë botën e tij. E përse?! "Vetëm e vetëm për ta patur pak mik atë!". Ky është vetëm një nga shumë paradokset që konsumohen në emër të këtij virtyti të lartë siç është *miqësia.*

Këtu mund të theksohet se nuk mund të marrë emrin *miqësi* raporti që prodhon një individ me gjithkënd tjetër të rastësishëm, vetëm e vetëm për t'i treguar botës se edhe ai ka miq. Sepse në të vërtetë ai akuzohet shpesh për faktin se "nuk do kishte se kujt t'i

kërkonte qoftë edhe një gotë ujë”-siç thotë populli. Pra ai mbetet një i vetmuar për faj eskluzivisht të tij, në këtë botë plot me njerëz e me *miqësira.* Ai dëshiron thjesht të tregojë në dukje dhe jo në përmbajtje, se ka miq.

Me fjalë të tjera, ky individ ka nevojë të shtiret e të justifikojë paaftësinë e tij në shoqëri dhe nuk ka aspak si qëllim të krijojë e të jetojë raporte vërtet *miqësore*, për të cilat bota ka aq shumë nevojë e pa të cilat njeriu nuk mund të jetojë si njeri.

Nuk mund të lihet pa u thënë se pas Krishtit, filloi të qartësohej dhe u bë gjithnjë e më konkrete ideja mbi *miqësinë*, sigurisht kjo edhe pas provave, shembujve dhe eksperiencave të Tij me Apostujt. Njerëzit, pas kësaj epoke, kanë mundësi të kuptojnë se *miqësia* nuk është diçka abstrakte, por as krejt e zakonshme. Ajo shihet si një gjë e shenjtë, që fle tek njeriu prej ndërmjetësisë së Shpirtit të Shenjtë, i cili zbret prej lart me vullnet të Krijuesit. Po kështu, si një gjë e shenjtë ajo përkufizohet edhe në jetën e përditshme sidhe në zhargonin e njerëzve që zakonisht nuk kanë asgjë të shenjtë ose lidhje me gjërat e shenjat. Pjesa më e madhe e tyre, në mënyrë retorike thonë, “motra është e shenjtë”, “toka është e shenjtë”, e po kështu pohojnë “miqësia është e shenjtë”. Sigurisht thonë një të vërtetë të madhe këta të pandërgjegjshëm edhepse fjalët i përdorin pa ua ditur kuptimin ose pa u thelluar në to.

Miqësia është e *Shenjtë*. Ajo nuk fle tek kushdo. Ajo vjen e zbret në mënyrë të padukshme nga Lart dhe prandaj themi se “ai është një njeri i Lartë” kur duam të përshkruajmë me solemnitet një person që na është shfaqur vërtet me virtyte miqësore.

Miqësia nuk preket, nuk hahet, nuk vishet, nuk duket me sy, nuk ka ngjyrime, nuk ka variante. Nuk është miqësi ajo që përshkruajmë kur themi “ unë atë e kam mik me versionin tim”. Jo, ajo nuk është miqësi! Ajo mund të jetë sjellje oportuniste, mashtruese, e bazuar në interesa të caktuara për rrethana të caktuara.

Miqësia vjen në formë energjie, si një bashkëudhëtare me Shpirtin e Shenjtë dhe zë vend në zemrën dhe mendjen e një personi. E që nga ai moment, ajo është e njejta gjë tek të gjithë, është e njejta ndjesi dhe kështu, të gjithë ata që e kanë brenda tyre komunikojnë nëpërmjet *saj*. Ajo zbret vetëm nga lart dhe prandaj i ngre gjithnjë lart në piedestal ata që e mbartin. Prej këtyre njerëzve bota zbukurohet e ndodhin mrekullitë.

Mund të thuhet se si në atë e në këtë kohë, ose më mirë në të gjitha kohrat, *miqësia* mund të konsiderohet si një cilësi që iu përket njerëzve të ndershëm dhe të mbarë, të cilët si një klasë shoqërore e konsoliduar, nëpërmjet saj, *miqësisë* pra, mund të garantojnë

mbarëvajtjen e shoqërisë dhe janë në gjendje të rregullojnë punët e shtetit.

Miqësia është ajo që reziston në kohë (kohët njerëzore), qoftë edhe me fragmente të shkëputura ose momente të shkurtra miqësie, të cilat të krijojnë atë sigurinë dhe ndjeshmërinë që të bëjnë të mendosh se ti me personin që e konsideron mik, ke lindur e je rritur sëbashku. **Eshtë pikërisht ajo që nuk ka interesa të tjera veç natyrales, modestes, të pastrës, të ndershmes dhe jetëgjatës miqësi.*

Unë e kam takuar, ose më mirë të them e kam parë tek njerëz që më kanë ofruar *miqësinë* e tyre dhe frytet që *miqësia* jep, do i rrëfej sipas një ngjarjeje të vërtetë të përjetuar nga un vetë pak kohë më parë…

-fund-

Nga rrënojat e botës ku po agonizojmë
do të ngrihemi vetëm nëpërmjet Dashurisë... duke parë lart!

autori